




QYTETARI 6



QYTETARI 6

AUTORE

YLLI BARDHI

ESTELA MANO

Tematika "Tregu Global" në këtë tekst është realizuar falë marrëveshjes së bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim për zbatimin e programeve të "Junior Achievement of Albania" i cili ofron edukim bashkëkohor ekonomik dhe sipërmarrës për nxënësit në të gjithë sistemin e arsimit para universitar në Shqipëri. Junior Achievement Worldwide® është një organizatë ndërkombëtare, e specializuar në edukimin praktik të të rinjve për ekonominë, financën dhe sipërmarrjen në mbarë botën.

"Junior Achievement of Albania dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim"
Përshtati për "Junior Achievement of Albania": Dorina Rapti (Tematika "Tregu Global")
© Copyright Junior Achievement Worldwide

Redaktore letrare:

Lisina Mano

Redaktore përgjegjëse:

Teuta Mati

Art grafik:

Gert Alibali

Kopertina:

Besa Mati

Botim 2026

ISBN 97899943-2-517-7

SHBLSH E RE

Rruga Mine Peza, 1/1 Tiranë

www.shblsh.com

info@shblsh.com



PËRMBAJTJA

1	KULTURA	
1.1	Kultura dhe larmia e saj	6
1.2	Diversiteti kulturor	9
1.3	Stereotipat kulturorë	12
1.4	Simbolet kulturore	15
1.5	Feja dhe media	18
1.6	Edukimi me bashkëjetesën paqësore	20
1.7- 8	Aktivitet: “Kultura ime, kultura jonë, kultura e të gjithëve”	22
1.9-10	Projekt: “Teknologjia: Miku që na ndihmon dhe sfida që duhet ta menaxhojmë”	24
1.11	Konfliktet dhe Dallimet Kulturore	27
1.12	Zgjidhja e konflikteve	30
1.13	Përsëritje. Test	

2	KOMUNITETI	
2.1	Çfarë është komuniteti?	33
2.2	Llojet e komunitetit	36
2.3	Shërbimet në komunitet	38
2.4	Të njohim komunitetin pranë nesh: Komuniteti urban dhe komuniteti rural	40
2.5	Ndryshimet brenda komunitetit. Ndryshime sasiore dhe cilësore	43
2.6-7	Projekt: Rreziqet dhe përfitimet e teknologjisë	45
2.8	Institucionet pranë komunitetit	48
2.9	Reagimi qytetar në shërbim të komunitetit	50
2.10	Korrupsioni	52
2.11	Pasojat e korrupsionit dhe si ta luftojmë	54
2.12	Përsëritje	
2.13	Test	
3	Tregu global	
3.1	Biznesi dhe klienti	57
3.2	Biznesi dhe kultura	60
3.3	Tregtia globale (ndërkombëtare)	63
3.4	Specializimi i vendeve në prodhim dhe tregti	66
3.5	Barrierat tregtare	69
3.6	Monedha dhe kursi i këmbimit	72
3.7	Fuqia punëtore globale	74
3.8	Përsëritje	77

1. KULTURA



Mozaiku i Tiranës është një monument arkeologjik i rrallë, i gjetur brenda territorit të qytetit të Tiranës. Në vitin 1972, gjatë punës për ndërtimin e pallateve në Lagjen Nr. 9 të qytetit të Tiranës, u zbuluan edhe rrënojat e një ndërtese antike, njëri nga mjediset e të cilit ishte i shtruar me mozaik

Shënim. Simboli i erës te Mozaiku i Tiranës, gjendet edhe në Mozaikun e Pallatit Valentini në Romë. Simboli i erës ndodhet edhe në mburojën e Ene Trojanit, në një vizatim të lashtë ku tregohet lufta e trojanëve dhe helenëve për marrjen e trupit të vvarë të Akilit. Në vizatim ndodhen emrat e luftëtarëve: nga e majta Ajaksi, Akili i vvarë, Parisi dhe Enea.

Çfarë është kultura?

Kultura është mënyra se si njerëzit jetojnë, mendojnë dhe shprehen brenda një shoqërie. Ajo përfshin gjuhën që ne flasim, veshjet tona, ushqimet që gatuajmë, festat dhe mënyrën se si sillemi me njëri - tjetrin.

Ne e ndeshim kulturën çdo ditë, jo vetëm në familje, por edhe në shkollë, në lagje apo në komunitete të tjera. Shpesh vëmë re se njerëz të ndryshëm mbajnë qëndrime të ndryshme për të njëjtën dukuri.

Një nga arsyt kryesore të këtij ndryshimi, është prejardhja e tyre kulturore: zakonet, traditat dhe vlerat me të cilat janë rritur në familje dhe vendin e banimit.

Çdo vend ka kulturën e tij, por edhe brenda një vendi, kulturat mund të ndryshojnë nga një krahinë në tjetrën. Kultura ka shumë rëndësi, sepse ndihmon në formimin e karakterit dhe personalitetit të çdo njeriu.

Kuptimi i fjalës “kulturë”

Kultura është tërësia e përvojës dhe e vlerave materiale e shpirtërore të një populli. Kultura është tërësia e përvojës, e njohurive dhe e shprehive të edukatës që ka fituar dikush në jetë. Në fillim ajo përdorej vetëm për përvojën në bujqësi, por më vonë njerëzit filluan ta përdornin edhe për mënyrën si shprehej një individ i caktuar, sjelljen e tij. Ashtu siç kultivohet toka, që të japë fryte, “kultivohet” edhe mendja e njeriut, përmes mësim, traditave dhe përvojave. Sot, kur themi kulturë, nënkuptojmë mënyrën e jetesës së një populli, vlerat e tij, edukimin dhe historinë që trashëgohet brez pas brezi.

Kultura shqiptare është pjesë e kulturës botërore, pasuri e madhe që spikat me traditat e saj, mikpritjen, veshjet popullore, këngët polifonike dhe zakone që na dallojnë nga të tjerët.



Shikoni kostumet popullore dhe shkruani mendimin tuaj në fletore:

- Çfarë simbolizojnë këto veshje popullore? _____

Kultura në botë

Në botë ekzistojnë shumë kultura. Kultura perëndimore i ka rrënjët në Greqinë dhe Romën e lashtë.

Ajo vlerëson demokracinë, të drejtat e njeriut dhe lirinë individuale. Kultura ka ndikuar shumë në mënyrën e jetesës në vendet europiane dhe në Amerikë.

Nga ana tjetër, kultura lindore, që vjen nga vendet e Azisë dhe Lindjes së Mesme, i jep rëndësi harmonisë me natyrën, moralit dhe traditave familjare. Shqipëria, për shkak të vendndodhjes së saj, ka qenë gjithmonë një urë lidhëse ndërmjet këtyre dy kulturave, duke marrë në kulturën e saj elemente si nga Lindja, ashtu edhe nga Perëndimi.



Në Europë

Trashëgimia kulturore e Europës është një pasuri shumë e madhe dhe e larmishme. Ajo përbëhet nga gjërat që kanë krijuar dhe lënë pas brezat e mëparshëm dhe që ne sot i ruajmë për brezat që do të vijnë. Kjo trashëgimi përfshin natyrën, ndërtesat dhe veprat monumentale, vendet arkeologjike,

muzetë, veprat e artit, qytetet historike, librat, muzikën, filmat dhe traditat.

Ajo përfshin gjithashtu dijet, zakonet dhe mënyrat e jetesës së njerëzve në Europë.



Në Afrikë

Kultura senegaleze është shumë e pasur dhe me veshje plot ngjyra. Ajo është përzierje traditash afrikane, ndikimesh nga Lindja e Mesme dhe elementesh të trashëguara nga historia e vendit. Senegali njihet si vend për mikpritjen e tij, që quhet *teranga*, vlerë shumë e rëndësishme që tregon gatishmërinë për të

ndarë, për të ndihmuar dhe për t'i bërë të tjerët të ndihen të mirëpritur.

Muzika dhe vallzimi janë pjesë e përditshme e jetës në Senegal; ritmet e mbalax dhe daullet tradicionale shoqërojnë festat, ceremonitë dhe tubimet familjare. Në art e zanate, njerëzit krijojnë vepra shumëngjyrëshe, si: punime druri, tekstile dhe veshje tradicionale plot motive.

Kultura ndryshon vazhdimisht



“Ne jemi ndryshe, por së bashku krijojmë mozaikun e njerëzimit.”

Veshjet tradicionale në kohën tonë i kanë lënë vendin veshjeve të kohës (moderne). Mënyrat e komunikimit janë transformuar për shkak të teknologjisë dhe disa zakone nuk praktikohen më si dikur. Megjithatë, edhe pse ndryshon, kultura ruan gjithmonë një pjesë të identitetit tonë, na tregon nga vijmë dhe kush jemi. Prandaj ka rëndësi të njohim dhe të vlerësojmë kulturën tonë, por të respektojmë edhe kulturat e popujve të tjerë. Edhe ne vetë jemi pjesë e një kulture, e cila ndikon në mënyrën se si mendojmë, marrim vendime dhe shohim botën.

Po ashtu, mësojmë të vlerësojmë kulturat e tjera, sepse çdo kulturë ka pasuritë dhe traditat e saj. Kur njohim kultura të ndryshme, kuptojmë pse shokët tanë mund të kenë këndvështrime ose sjellje të ndryshme nga tonat.

Ashtu si kultura shqiptare na mëson respektin, mikpritjen dhe traditat tona të bukura, edhe kulturat e tjera i ndihmojnë njerëzit të formojnë identitetin e tyre dhe të bashkëjetojnë në harmoni me të tjerët.



Pyetje për diskutim

1. Çfarë është kultura?
2. Si ka ndryshuar kuptimi i fjalës “kulturë” nga e kaluara deri sot?
3. Vëreni dy veshje të paraqitura në mësim dhe diskutoni.
4. Pyet prindërit dhe përshkruaj disa elemente kulturore që kanë ndryshuar nga fëmijëria e tyre deri te brezi i sotëm. (Mund të krahasosh: veshjet, zakonet, festat, ushqimet, mënyrat e komunikimit, lojërat, muzikën etj.)



Fjalor

Diversitet - gjendjen kur ka shumë lloje, forma ose dallime, ose përfshirjen e njerëzve me prejardhje, kultura, ide apo karakteristika të ndryshme.

mozaik – art dekorativ, ku copëza të vogla guri ose mermeri ngjiten, për të formuar një figurë artistike.

human - qenie njerëzore, pra një person që i përket llojit Homo sapiens. Në përdorim të përditshëm, nënkupton gjithçka që ka të bëjë me njerëzit: mendimet, sjelljet, veçoritë tona.



1. Kërkoni në internet me tri fjalët kyçe: “fjalor shqip online”. Sa rezultate u gjetën nga shfletuesi?
2. Zgjidhni faqen që ju përshtatet më shumë (p.sh.: www.fjalorthi.com) dhe kërkoni fjalët: “traditë”, “respekt”, “sjellshëm”, “mikpritje”, “zyrtare”. Shkruani në fletore përkufizimet e tyre, duke u përpjekur që të kujtoni saktë kuptimin që lexuat.

Çfarë është diversiteti kulturor?

Diversiteti kulturor ka të bëjë me shumëllojshmërinë apo larminë e mënyrave sesi jetojnë, mendojnë dhe shprehen njerëzit në botë. Ai përfshin: gjuhët, traditat, veshjet, ushqimet, festat, zakonet dhe vlerat që çdo popull ka trashëguar brez pas brezi. Në klasën, shkollën ose lagjen tuaj mund të takoni njerëz me prejardhje të ndryshme, të cilët sjellin me vete zakone dhe ide që e pasurojnë komunitetin ku jetoni.

Diversiteti kulturor është diçka e natyrshme.

Njerëzit në vende të ndryshme kanë jetuar në mënyra të ndryshme. Kjo gjë e bën botën më interesante.

Ju duhet t'i vlerësoni këto dallime kulturore, duke jetuar në paqe e mirëkuptim me shokët, shoqet, komunitetin, duke nderuar dhe respektuar vlerat e njëri - tjetrit.



Origjina dhe kuptimi i fjalës "diversitet"

Fjala, "diversitet" vjen nga gjuha latine, "diversus", që do të thotë "i ndryshëm" ose "i larmishëm".

Ajo përdoret për të shpjeguar praninë e shumë llojeve, formave ose zakoneve kulturore brenda të njëjtit grup njerëzish.

Kur dëgjoni të flitet për diversitet kulturor, nënkuptoni që njerëzit që jetojnë në të njëjtin vend apo në një komunitet, mund të kenë tradita të ndryshme, sepse janë nga vende të ndryshme. Ata dallojnë nga mënyra e komunikimit, mënyra e sjelljes dhe nga ndryshime të menduarit për një problem të caktuar.

Kjo larmi vlen shumë, sepse secili sjell diçka të veçantë dhe pasuron komunitetin.



Pse ka rëndësi diversiteti kulturor?

- E pasuron jetën tuaj, me mënyra të reja të menduarit.
- Ju mëson të respektoni njerëzit që janë të ndryshëm nga ju.
- Ndhmon në bashkëjetesë paqësore, sepse kur kuptoni kulturat e të tjerëve, jeni më të hapur kuptoni më shumë.
- Ndërton urë lidhëse, ju afron me komunitete të tjera.

Ashtu siç duam të ruajmë kulturën tonë shqiptare me: mikpritjen, traditat, folklorin dhe festat tona, ashtu duhet të respektoni edhe kulturat e tjera që bashkëjetojnë me ju.



"Jeni të ndryshëm, por këto ndryshime ju mësojnë të bashkëjetoni në paqe."

Dukuri të ndryshme kulturore



Nënkultura, është një grup njerëzish brenda shoqërisë që kanë tradita, zakone, veshje, gjuhë ose interesa të veçanta, që i dallojnë nga të tjerët. Këto dallime nuk janë të mëdha sa të krijojnë një shoqëri tjetër, por mjaftueshëm për t'i bërë ata unikë në mënyrën si jetojnë. Në Shqipëri ka shumë nënkultura të formuara nga traditat e krahinave, nga mënyrat e

jetesës, nga interesat e të rinjve apo nga zakone të trashëguara. Për shembull, të rinjtë që ndajnë të njëjtin stil muzike dhe veshjeje, ose banorët e veriut, jugut apo lindjes, që kanë zakone dhe mënyra të ndryshme të të folurit, përbëjnë nënkultura të ndryshme.



Ka grupe njerëzish që nuk pajtohen me disa rregulla, zakone apo vlera të shoqërisë dhe kërkojnë të jetojnë ndryshe nga pjesa tjetër e saj.

Këto grupe shpesh përpiqen të sjellin ide të reja, me bindjen se po ndihmojnë shoqërinë të përmirësohet. Shembuj të kundërkulturës janë lëvizjet që mbrojnë mjedisin kundër ndotjes, apo të rinjtë që shprehin mënyra të veçanta arti, muzike dhe sjelljeje për të treguar se duan më shumë liri dhe ndryshim.



1. Kërkoni në internet me fjalët kyçe: "adresë zyrtare instituti trashëgimi kulturore".
Për çfarë bëhet fjalë?
2. Cilat faqe do të përdornit për të shkruar një historik të shkurtër mbi traditat shqiptare?
A janë ato faqe zyrtare?
3. Shkruani në fletore një shkrim të shkurtër mbi traditat shqiptare (10-15 fjali),
ku të përmendni tri veçanti që ju tërheqin.

Dialektet dhe të folurit

Dialektet janë mënyra të ndryshme të të folurit që tregojnë historinë, traditat dhe kulturën e zonave të ndryshme të Shqipërisë. Ato janë pasuri e rëndësishme kulturore dhe duhet të respektojmë mënyrën si flet çdo person.

Në Shqipëri fliten dy dialekte kryesore:

1. Dialekti Gegë	2. Dialekti Toskë
Ku flitet? - Në Shqipërinë e veriut - Në Kosovë - Në Maqedoninë e Veriut - Në Malin e Zi	Ku flitet? - Në Shqipërinë e Jugut
Shembuj fjalësh: - Unë jam → un jam / une jam - Është → asht - Mirë → mire / mirë	Shembuj fjalësh: - Unë jam → unë jam - Është → është - Mirë → mirë

Shënim: Dialektet janë pasuri kombëtare, që i japin bukuri jetës në familje e shoqëri. Shpesh ato bëhen subjekt i situatave komike, që japin gëzim, zbukurojnë, pasurojnë të folurit. Por në shkollë, në zyrat e shtetit, flitet dhe shkruhet gjuha shqipe standarde, pa dialekte.



Pyetje për diskutim

1. Çfarë kupton me shprehjen “diversitet kulturor”?
2. Pse duhet të respektojmë kulturat e tjera?
3. Cilat janë disa nga elementet që përbëjnë kulturën e një populli?
4. Cilat ngjashmëri dhe dallime vëren mes kulturës shqiptare dhe kulturave të tjera?
5. Diskuto në klasë ndonjë zakon ose festë që i përket kulturës tënde familjare.
6. Pyet prindërit: për fjalë të cilat përdoren vetëm në dialektin e zonës nga jeni ju.



Fjalor

Diversitet - prania e shumë formave, zakoneve ose njerëzve të ndryshëm brenda një grupi.

Dialekt - Quajmë një mënyrë të veçantë të të folurit, që përdoret në një zonë të caktuar të një vendi. Njerëzit që flasin të njëjtën gjuhë mund ta shqiptojnë ndryshe, të përdorin fjalë të tjera, apo të kenë mënyra të ndryshme komunikimi, dhe këto dallime krijojnë dialekt.

Çfarë janë stereotipat kulturorë?

Stereotipat kulturorë janë ide të përgjithshme dhe të thjeshtuara që njerëzit krijojnë për grupe të caktuara shoqërore, kulturore ose fetare. Ato zakonisht lindin nga mungesa e informacionit të saktë dhe të plotë dhe nga përsëritja e zakoneve të vjetra.

Stereotipat mund të jenë:

Pozitivë, si për shembull kur dëgjon: “të gjithë italianët janë kuzhinierë të mirë”.

Negativë, si për shembull: “një kulturë, ka më pak vlerë se një tjetër”.

Të dy llojet e stereotipave janë të gabuara, sepse asnjë grup njerëzish nuk mund të përkufizohet vetëm me një cilësi, duhet studim i madh për të bërë përcaktime të tilla.



*Tradita dhe zakone kulturore në
Pazarin e vjetër të Krujës*

Pse krijohen stereotipat?

Stereotipat krijohen nga:

- a. Traditat dhe zakonet e trashëguara;
- b. Mungesa e kontaktit me kultura të tjera;
- c. Pamja e njëanshme e media-s;
- d. Në disa raste, frika nga ndryshimet.

Marrim si shembull stereotipat kulturorë.

Njerëzit shpesh gjykojnë kulturat vetëm, nga ajo që kanë dëgjuar. Kjo krijon paragjykime si:

- a. “Të gjithë afrikanët vishen njëlloj”;
- b. “Disa kultura janë më të zhvilluara se të tjerat”;
- c. “Disa zakone janë të çuditshme apo të gabuara”.

Në të vërtetë, çdo kulturë ka vlera, tradita, histori dhe mënyra jetese që duhen respektuar. Të gjitha kulturat me cilësitë e tyre të çmuara ndihmojnë në pasurimin e botës sonë dhe në ndërtimin e bashkëjetesës paqësore.

Stereotipat gjinorë

Pjesë e rëndësishme e stereotipave kulturorë janë edhe ato gjinore.

Rolet gjinore në shoqëri

Që në shoqëritë e lashta, gjinia ka përcaktuar rolet e individëve në familje dhe në komunitet. Në fillim ekzistonte familja matriarkale, ku gruaja kishte rolin kryesor për shkak të punëve që kryente në: bujqësi, blegtori, përgatitje veshjesh dhe enësh prej balte etj. Më vonë, me shpikjen e mjeteve të punës në bujqësi, kërkohej më shumë forcë fizike, gjë që çoi në kalimin drejt familjes patriarkale, ku burri mori rolin kryesor në punët jashtë shtëpisë dhe mbajtjen e familjes. Në periudhën bashkëkohore ku jetoni, rolet gjinore janë transformuar shumë, shpesh në dobi të së mirës, vlerave të spikatura.

Sot burrat dhe gratë gëzojnë me ligj barazinë dhe mund të kryejnë të njëjtat profesione, të marrin pagesë sipas punës që kryejnë, jo sipas gjinisë.

Shembuj të roleve të reja

Gratë në drejtim (*leadership*), në drejtim shkolle, biznesesh, institucionesh etj., por edhe në familje.

Ursula fon der Leyn, fizikane, politikane, prej vitit 2019 është Presidente e Komisionit Europian.

Roberta Metsola, politikane, Presidente

e Parlamentit Europian. Ajo është mbrojtëse e vlerave të BE, lirisë së shprehjes dhe shtetit të së drejtave. Mbështet procesin e zgjerimit të BE, me përfshirjen e Ballkanit Perëndimor, ku vendi ynë bën pjesë. Shqipëria punon për standardet që të futet në BE me të drejta të plota.

Burrat në drejtim (*leadership*), në drejtim institucionesh, automjetesh, fabrikash por edhe në përkujdesje për fëmijët, shoqërim në shkollë, blerje ushqimesh, ndihmë për detyrat e familjeve etj.

Stereotipat gjinorë, pra janë ide të paracaktuara për mënyrën se si “duhet” të sillen djemtë dhe vajzat.

Shembuj të zakonshëm që jo gjithmonë janë të vërtetë: “Djemtë janë më të fortë”;

“Vajzat duhet të merren me punët e shtëpisë”;

“Djemtë janë më të mirë në sporte”;

“Vajzat janë më të mira në shkencat ekzakte”.

Pse janë të dëmshme këto përcaktime?

Sepse kufizojnë ndikojnë në mendjen e fëmijëve mundësitë e fëmijëve, ulin vetëbesimin dhe ndikojnë në zgjedhjen e profesioneve për të ardhmen.

Si t'i sfidojmë stereotipat kulturorë?

- Të njihni kultura të ndryshme, tradita dhe mënyra të reja jetese.
- Të pyesni, të mësoni, në vend që të paragjykoni.
- Të kuptoni se mendimi i tjetrit respektohet, nuk përcakton karakterin e personit.
- Të vëzhgoni shembuj pozitivë, ku burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat punojnë bashkë. Promovoni barazinë, respektin dhe bashkëpunimin.


Diskutoni raste të shfaqjes së respektit të ndërsjellë në klasën tuaj.



Ursula fon der Leyen



Roberta Metsola





Beatrice venezi, dirigjente orkestre

Shembuj të sjelljes pa stereotipa:

Respektoni sjelljet, zakonet e shokëve që vijnë nga zona të ndryshme të vendit.

Pranoni vajzat dhe djemtë në aktivitete, pa menduar se: "është për djem" apo: "është për vajza".

Mësoni për festat kulturore të ndryshme.

Kuptoni se çdo njeri është i veçantë, pavarësisht kulturës apo gjinisë së tij.



1. Merrni pranë një orë ose pajisje dixhitale dhe matni kohën që ju duhet për të kopjuar në fletore pjesën: "Si t'i sfidojmë stereotipat kulturorë?" (përveç fjalisë së fundit)
2. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.



Pyetje për diskutim

1. Çfarë janë stereotipat kulturorë?
2. Pse krijohen stereotipat për kultura të ndryshme?
3. Çfarë janë stereotipat gjinorë?
4. Si mund të sfidoni stereotipat kulturorë në jetën e përditshme?
5. Përse është e rëndësishme të njihni dhe respektoni kulturat e tjera?
6. Shkruani në fletoren tuaj dy shembuj stereotipash gjinorë.



Fjalor

Stereotip - një ide e përgjithshme, të thjeshtuar dhe zakonisht të gabuar që njerëzit krijojnë për një grup personash (kulturor, gjinor, fetar, social).

Lidership - aftësia për të udhëhequr, drejtuar dhe frymëzuar të tjerët në një klasë, grup, familje apo komunitet.

Në foto paraqitet nusja me veshjen karakteristike të dasmës., vërehet gati në të gjithë botën gjatë ceremonisë. Çfarë ju sjell në mendje ky fustan? Keni foto të tilla në shtëpi?

A mund të vishet ky fustan për pushime?

Çfarë janë simbolet kulturore?

Simbolet kulturore janë shenja, objekte, veshje, këngë, tradita, ndërtesa, rite apo mënyra sjelljeje që përfaqësojnë historinë, identitetin dhe vlerat e një populli. Ato ju tregojnë kush jeni, nga vini dhe çfarë vlerësoni në shoqëri. Simbolet kulturore janë si pasaporta e një kombi, sepse përmes tyre prezantoheni para botës.

Kur shikoni një simbol kulturor, nuk shikoni vetëm një objekt. Ju shihni histori, tradita, vlera dhe kujtime të brezave të kaluar.



Simbolet kulturore shqiptare

Vendi ynë, Shqipëria ka trashëgimi shumë të pasur, me simbole që tregojnë lashtësinë e popullit tonë si:

Veshjet tradicionale

Plisi i bardhë – simbol i burrërisë dhe i identitetit shqiptar.

Xhubleta – veshje tepër e lashtë e grave të veriut, unike në botë.

Fustanella – veshje e vjetër e burrave, përdorur në jug dhe në qendër.

Opingat – këpucë të punuara me dorë.

Objekte dhe shenja kombëtare

Shqiponja dykrenare – simbol i lirisë, vendosur në flamurin shqiptar.

Kullat e veriut – ndërtesa prej guri që simbolizojnë mikpritjen dhe qëndresën.

Çiftelia dhe lahuta – instrumente muzikore me histori shekullore.



Tradita dhe këngë

Iso-polifonia – mënyrë e veçantë e të kënduarit në jug, vlerësuar nga UNESCO.

Vallet tradicionale – ritet shoqëruese në festa, dasma dhe gëzime familjare.

Simbole tregojnë se shqiptarët kanë qenë popull i fortë, i organizuar dhe me tradita.





Simbolet kulturore në botë

Simbolet kulturore nuk i ka vetëm Shqipëria. Çdo vend në botë ka simbolet e tij, që e bëjnë atë të veçantë, unik.

Veshjet tradicionale

Kimono (Japoni) – veshje tradicionale me motive natyrore, e përdorur në ceremoni. *Sombrero (Meksikë)* – kapelë e madhe shumëngjyrëshe që tregon kulturën meksikane. *Dirndl dhe Lederhosen (Gjermani/Austri)* – kostume tradicionale të festës së birrës (Oktoberfest).

Ndërtesa dhe monumente

Koloseu (Romë) – simbol i kulturës romake dhe historisë së lashtë.

Kulla Eiffel (Francë) – simbol i Parisit dhe artit francez.

Piramidat e Egjiptit – simbole të qytetërimit egjiptian, që lidhen me jetën dhe besimin e faraonëve.

Muri i Madh i Kinës – simbol i historisë dhe i mbrojtjes.

Këngë, vallje dhe zakone

Flamenco (Spanjë) – vallëzim pasionant që shpreh ndjenja, histori të popullit spanjoll.

Tango (Argjentinë) – këngë dhe valle e njohur në mbarë botën.

Hula (Havai) – vallëzim që rrëfen legjenda dhe mite të lashta.

Origami (Japoni) – arti i palosjes së letrës, simbol i durimit dhe krijimtarisë.

Simbolikë fetare dhe shpirtërore

Kryqi i krishterë – simbol i fesë së krishterë.

Hëna e Islamit – simbol në shumë vende myslimane.

Lotusi (Indi/ Azi) – simbol i paqes, pastërtisë dhe shpirtit.

Të gjitha këto simbole tregojnë larminë e kulturave në botë dhe mënyrat e ndryshme sesi popujt shprehin identitetin e tyre.

Pse janë të rëndësishme simbolet kulturore?

Simbolet kulturore ndihmojnë, ruajnë historinë. Ato tregojnë sesi kanë jetuar të parët: çfarë muzike dëgjonin, si visheshin, si ndërtonin shtëpi, si festonin.

Ato bashkojnë njerëzit. Një këngë tradicionale, një flamur, një valle e vjetër, i bën njerëzit të ndihen pjesë e të njëjtit grup, e të njëjtës kulturë.

Dalloni kulturat e tjera

Çdo vend ka simbole unike që e bëjnë të veçantë.

Shumë simbole ju mësojnë për: mikpritjen, besën, respektin, paqen dhe bashkëjetesën.

Simbolet kulturore ndryshojnë me kohën

Ashtu si njerëzit dhe shoqëritë ndryshojnë, edhe simbolet kulturore marrin forma të reja. Veshjet tradicionale sot përdoren vetëm në festa, jo përditë. Disa këngë të vjetra ruhen në festivale. Mobiljet, shtëpitë dhe objektet e dikurshme sot janë muze. Disa simbole të vjetra kthehen në modë nga brezi i ri. Por pavarësisht ndryshimeve, kuptimi i tyre mbetet i rëndësishëm, sepse ato formojnë rrënjët e kulturës sonë.



Pyetje për diskutim

1. Çfarë janë simbolet kulturore? Përshkruaj rolin e tyre.
2. Kur janë krijuar simbolet kulturore?
3. A ndryshojnë simbolet kulturore me kohën?
4. Listo disa simbole kulturore të ne?



Fjalor

Simbol - quajmë një shenjë, objekt, figurë, veshje, ngjyrë ose gjest që përfaqëson një ide, një vlerë, një traditë ose një grup njerëzish.

Detyrë

Shprehja: "Shtëpia e shqiptarit është e mikut", orienton sjelljen në familje dhe komunitet. Çfarë mësimi mund të nxirri nga kjo shprehje?

Aktivitet krijues

"Krijë simbolin tënd kulturor!"

Mendo për një vlerë që për ty ka rëndësi si: miqësia, respekti, paqja, besa, mikpritja, harmonia, bashkëpunimi. Mendo se çfarë objekti, forme, ngjyre apo shenje, mund ta përfaqësojë këtë vlerë. Krijë një vizatim, një simbol, ose një stemë të vogël që e përfaqëson idenë tënde.

Shkruaj poshtë simbolit tënd një përshkrim të shkurtër duke shpjeguar:

Pse e zgjodhe këtë formë? Çfarë kuptimi ka simboli yt?

Çfarë vlerash përfaqëson? Si lidhet ky simbol me kulturën tënde ose vlerat e klasës?

Shembull i thjeshtë:

Simbol i krijuar: Një dorë e hapur me një zemër në qendër.

Kuptimi: Dora e hapur tregon mikpritjen; zemra tregon dashurinë dhe respektin.

Vlera: Tregon se si ne i mirëpresim njerëzit dhe kujdesemi për njëri - tjetrin.


Çdo nxënës paraqet simbolin e vet përpara klasës.

Simbolet vendosen në një poster të madh me titullin: "Simbolet e vlerave të klasës sonë".

Ky poster mund të vendoset si dekor në klasë gjatë gjithë vitit.



1. Merrni pranë një orë ose pajisje digjitale dhe matni kohën që ju duhet për të shkruar në fletore një shkrim të shkurtër (rreth 10-15 fjali) mbi një vend që keni vizituar. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.
2. Shkruani me kompjuter krijimin tuaj duke përdorur programin Word. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.
3. A mund ta përktheni krijimin tuaj në gjuhë të huaj? Në cilën gjuhë? Si do të vepronit?



Diversiteti fetar në botë dhe rëndësia e tij kulturore

Bota ku jetojmë është shumë e larmishme. Në vende të ndryshme njerëzit besojnë, festojnë dhe praktikojnë fe të ndryshme, të cilat janë pjesë e kulturës së tyre. Ky diversitet fetar është pasuri e madhe kulturore, që tregon mënyrat e ndryshme se si popujt shprehin vlerat, traditat dhe historinë e tyre.

Në shumë vende, fe të ndryshme bashkëjetojnë prej shekujsh dhe janë pjesë e identitetit kulturor të tyre. Për shembull:

Në Indi, hinduizmi, islamizmi, krishterimi dhe besime të tjera, jetojnë krah për krah. Festa si Divali, Bajrami dhe Krishlindjet festohen nga komunitete të ndryshme dhe njerëzit marrin pjesë në festat e njëri - tjetrit. Në Indonezi, vendi me numrin më të madh të myslimanëve në botë, ka edhe miliona të krishterë, budistë dhe hinduistë. Ata organizojnë bashkë

shfaqje kulturore dhe i shikojnë dallimet si pjesë të identitetit kombëtar.

Në Ballkan edhe në Shqipëri, bashkëjetesa fetare është pjesë e kulturës lokale.

Për shembull, në shumë qytete festat e Bajramit, Pashkëve dhe Krishtlindjeve respektohen dhe urimet shkëmbehen mes të gjithëve, pa dallim feje. Pra kemi një shembull të bukur të harmonisë kulturore. Ky lloj diversiteti fetar tregon se njerëzit mund të besojnë në gjëra të ndryshme, por mund të ndajnë vlera të njëjta, si: paqja, familja, ndihma, solidariteti dhe dashuria për njeriun.

Diversiteti fetar dhe media

Media luan rol shumë të rëndësishëm në mënyrën sesi publiku e sheh këtë larmi fetare.

Kur media tregon në televizion festa të ndryshme fetare, aktivitete bamirësie nga komunitete të ndryshme, përfaqësuesit e feve të ndryshme, punojnë së bashku. Kështu ata edukojnë njerëzit të respektojnë kulturat dhe besimet e ndryshme. Media jo vetëm informon, por ndërton ura komunikimi midis kulturave dhe feve.

Shembull nga historia shqiptare

Shqipëria është një nga vendet e ralla ku komunitetet fetare kanë bashkëjetuar prej shekujsh. Në vitin 1920, gjatë zhvillimit të punimeve të Kongresit të Lushnjës, përfaqësues të besimeve të ndryshme fetare, punuan së bashku për të mbrojtur pavarësinë e vendit. Media e kujton këtë moment historik në dokumentarë dhe emisione, për të treguar se bashkëveprimi fetar është pjesë e identitetit kulturor shqiptar.

Ky është shembull se si media mund të përdorë historinë për të forcuar mesazhin e bashkëjetesës dhe jo për të nxitur dallime.

Roli i medias në paraqitjen e diversitetit kulturor fetar

Shkolla jonë është laike, por respekton individët që me dëshirën e tyre, besojnë një fe të caktuar. Media ka fuqi të madhe që njerëzit të kuptojnë dhe interpretojnë fenë.

Ajo ndihmon publikun e gjerë të kuptojë larinë kulturore fetare, duke shpjeguar historinë, vlerat dhe traditat e secilit komunitet fetar. Sa më e saktë të jetë media, aq më pak keqkuptime dhe paragjykime ka në shoqëri.

Media:

- U jep njerëzve informacion të drejtë dhe të qartë. Për shembull, në një dokumentar mund të shpjegohet pse myslimanët festojnë Fitër Bajramin, apo çfarë simbolizon Pashka për të krishterët.
- Tregon histori bashkëpunimi ndërfaqetare. Për shembull, media raporton kur komunitetet fetare bashkohen për të ndihmuar në një fatkeqësi natyrore - duke treguar se vlerat humane janë të përbashkëta për të gjitha fetë.

Së bashku kundër dhunës

- Ndihmon në luftimin e paragjytimeve. Gazetarët profesionistë shmangin gjuhën e urrejtjes dhe përdorin tone të qeta, të sakta dhe të respektueshme, që forcon kulturën e tolerancës.
- Nxist dialog dhe respekt. Në shumë emisione ftohen përfaqësues nga besime të ndryshme për të diskutuar tema si: paqja, familja, ndihma reciproke, edukimi.

Kështu publiku kupton se diversiteti fetar është pasuri kulturore, jo arsye ndarjeje.

Media si urë komunikimi për të rinjtë

Të rinjtë janë përdoruesit më të shpeshtë të rrjeteve sociale. Për ta, media është një mënyrë e natyrshme për të mësuar dhe për t'u lidhur me botën. Kur feja paraqitet me gjuhë të thjeshtë, me video të shkurtra ose me mesazhe motivuese, të rinjtë mësojnë vlera të rëndësishme kulturore dhe shoqërore.

Shembuj nga jeta e përditshme

Një video e shkurtër në Instagram, ku përfaqësues nga besime të ndryshme dërgojnë urime për paqen; një emision në televizion ose radio, ku të rinjtë diskutojnë se si mund të luftohet gjuha e urrejtjes. Pra media nuk është vetëm mjet informimi, por mjet edukimi kulturor, që i mëson fëmijët dhe të rinjtë të respektojnë diversitetin fetar.



- 1. Krijoni skica të thjeshta në fletoren e vizatimit mbi rëndësinë kulturore të diversitetit fetar.**
- 2. Vizatoni me kompjuter krijimet tuaja duke përdorur programin Paint.**
Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.
- 3. Me ndihmën e mësuesit/es, printoni një poster artistik me krijimet dixhitale.**

**Pyetje për diskutim**

- 1. A është media një mjet i rëndësishëm për fenë? Pse?**
- 2. Pse vlerat kulturore të feve të ndryshme, mund t'u tregohen të rinjve nëpërmjet medias?**
- 3. A mundet media të promovojë dialogun fetar?**
- 4. Çfarë vlerash keni dëgjuar që mund të përcjellë një mesazh fetar?**
- 5. Detyrë: Krijoni një mesazh të shkurtër për rrjetet sociale (një slogan ose postim të shkurtër) me temën: "Media dhe paqja".**

**Fjalor**

Sinagogë - quhet vendi i lutjes dhe të mbledhjes së komunitetit hebre. Aty besimtarët hebrej falen, studiojnë librat e shenjtë dhe zhvillojnë aktivitete fetare e kulturore.



Larmia fetare dhe bashkëjetesa

Në botë ka shumë fe të ndryshme, secila me traditat, rregullat dhe mënyrën e vet të adhurimit. Kjo do të thotë se njerëzit nuk besojnë të gjithë njësoj, por kjo larmi është një pasuri e madhe kulturore. Ajo i mëson fëmijët se njerëzit mund të jenë të ndryshëm në besim, por të ngjashëm në vlera dhe sjellje të mira. Shembuj nga vende të botës tregojnë se fe të ndryshme mund të bashkëjetojnë qetësisht.

Për shembull:

- Në Indi, nxënësit në të njëjtën shkollë mund të festojnë Festën e Dritave (Divali), Bajramin dhe Krishtlindjet së bashku.
- Në SHBA, në një lagje mund të gjesh: kisha, xhami dhe sinagoga pranë njëra-tjetrës, duke treguar respekt dhe liri besimi.
- Në Indonezi, një vend me shumë fe, njerëzit shpesh organizojnë aktivitete të përbashkëta për komunitetin.

Edhe në Shqipëri, bashkëjetesa fetare është një vlerë e trashëguar.

Në shumë qytete njerëzit të urojnë njëri - tjetrin për festa të ndryshme fetare, pavarësisht se cilës fe i përket familjet e tyre. Ky është një shembull i qartë i tolerancës dhe respektit. Edukimi është procesi i ndërtimit të njohurive, aftësive, sjelljeve dhe vlerave që ndihmojnë nxënësit të përballen me jetën dhe të rriten si qytetarë të mirë. Përveç dijeve, edukimi përfshin edukimin moral, kulturor, qytetar, emocional dhe fizik.

Njohja me kulturat fetare, nuk ka qëllim t'u mësojë fëmijëve të praktikojnë një fe të caktuar. Nxënësi të kuptojë vlerat si: respekti, paqja, drejtësia, falja dhe mirësia.

Kështu fëmijët ndihmohen të kuptojnë edhe besimet e njerëzve të tjerë, pa paragjykim dhe pa diskriminuar askënd. Në Shqipëri, shkollat publike janë laike, nuk mësohet edukimi fetar. Por aty nxënësit edukohen të respektojnë të gjitha fetë dhe të kuptojnë rëndësinë e lirisë së besimit. Një shtet laik nuk ka fe zyrtare, por garanton të drejtën e çdo individi për të besuar ose për të mos besuar.



Manastiri i Ardenicës

Vlerat që përcjellin fetë në Shqipëri

Edhe pse njerëzit mund të jenë pjesë e feve të ndryshme, fetë mësojnë thajse të njëjtat vlera pozitive:

1. Respekti për tjetrin: Fe të ndryshme mësojnë se njerëzit duhet të sillen mirë me njëri - tjetrin, të pranojnë dallimet dhe të mos diskriminojnë askënd.

2. Dashuria dhe mirësia:

Mbledhja e ushqimeve ose veshjeve për familjet në nevojë në festat fetare.

3. Falja dhe paqja: Fetë mësojnë se duhet të shmangim dhunën dhe të falim gabimet për të jetuar në qetësi. Të pajtohesh me një shok pas një zënke të vogël.

4. Ndershmëria dhe drejtësia: Feja mëson që të jemi të ndershëm dhe të mos marrim atë që nuk na takon.
Shembull: Të thuash të vërtetën edhe kur ke frikë se ndëshkohesh.

5. Familja dhe komuniteti: Feja inkurajon respektin për prindërit, kujdesin për të moshuarit dhe bashkëpunimin në komunitet.

Shembull: Të ndihmosh prindërit në shtëpi ose të marrësh pjesë në aktivitete të lagjes.

Këto vlera janë shumë të rëndësishme sidomos sot, kur bota ndryshon shpejt dhe njerëzit kanë nevojë për udhëzime morale që i ndihmojnë të ndërtojnë një shoqëri të drejtë, të sigurt dhe paqësore. Shkolla ka një rol shumë të rëndësishëm, është vendi ku fëmijët mësojnë të bashkëjetojnë me njëri - tjetrin, të respektojnë ndryshimet dhe të rriten si qytetarë që kuptojnë vlerat e shoqërisë.



Veprimtari në klasë – Lojë me role: "Respekto shokun"

Nxënësit organizohen në role dhe analizojnë situatat më poshtë për të kuptuar si të tregojnë respekt e tolerancë:

Situata 1: Një nxënës feston Krishtlindjet, të tjerët jo. Si mund ta urojmë atë? A duhet ta përjashtojmë?

Situata 2: Një nxënës mban një simbol fetar të fesë myslimane. Si duhet të reagojmë për të treguar respekt për atë?



Pyetje për diskutim

1. Çfarë është edukimi fetar?
2. A inkurajon feja respektin në familje dhe barazinë e burrave me gratë

Detyrë

"Një shoqëri e drejtë fillon nga mënyra se si sillemi me njëri-tjetrin." Përshkruaj mesazhin që merr nga kjo thënie.



Fjalor

Divali - është një festë shumë e rëndësishme hindu, e njohur edhe si: "*Festa e Dritave*". Gjatë kësaj feste, njerëzit ndezin qirinj dhe llamba të vogla për të simbolizuar fitoren e dritës ndaj errësirës, së mirës ndaj së keqes dhe shpresës ndaj frikës.



*Shpella e Shenjtë e Malit të Krujës
"Sari Salltik"*



Manastiri i Zvërnecit



1.7 - 1.8 AKTIVITET

"KULTURA IME, KULTURA JONË, KULTURA E TË GJITHËVE"

Kultura është mënyra se si një popull jeton, flet, feston dhe ruan traditat e tij. Ajo përfshin gjithçka: veshjet popullore, ushqimet tradicionale, mënyrat e të folurit, këngët, mënyrat e mikpritjes, jetën familjare dhe artin. Shqipëria ka një trashëgimi kulturore shumë të pasur, e cila shihet në qytetet e vjetra, festat tradicionale, veshjet e dallueshme, muzikën dhe gatimet e veçanta të zonave të ndryshme të vendit.

Disa prej këtyre pasurive janë edhe pjesë e listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCOs, si: Berati, Gjirokastra, Butrinti dhe isopolifonia shqiptare - të gjitha dëshmi të vlerave të mëdha, që vendi ynë i ka ruajtur prej shekujsh.

Trashëgimia kulturore nuk kufizohet vetëm te monumentet; ajo përfshin edhe gastronominë, si: petaniku i Korçës, byreku dhe flija, gatimet e jugut me erëza, apo ushqimet e thjeshta të veriut. Po ashtu, muzetë dhe galeritë, si: Muzeu Historik Kombëtar, Qendra "Marubi" ose kalatë e Shkodrës, Krujës, Gjirokastrës, që tregojnë historinë, artin dhe mënyrën e jetesës së të parëve tanë. Këto elemente ju ndihmojnë të kuptoni se kultura shqiptare është e gjerë dhe shumëdimensionale. Kur kupton traditat e vendit tënd, mëson edhe të respektosh kulturat e tjera pa gjykim, sepse çdo popull ka mënyrën e vet të jetesës.

Studiuesit e Vegjël të Kulturës

Ndahuni në 3 grupe.

Secili grup merr rolin e studiuesve të kulturës shqiptare dhe punon mbi një temë të veçantë.

Grupi A: Trashëgimia shqiptare

Përzgjidhni një pasuri kulturore, si: Berati, Gjirokastra, Butrinti, iso-polifonia, Xhubleta, një veshje tradicionale ose një muze kombëtar dhe gjeni:

- Çfarë simbolizon?
- Çfarë tregon për historinë tonë?
- Pse është e rëndësishme të ruhet?

Shembull: një foto nga një vizitë në muze ose të përshkruajnë një gatim tradicional të zonës tuaj.

Grupi B: Diversiteti kulturor brenda Shqipërisë

Analizoni dallimet mes krahinave shqiptare: dialektet, ushqimet, festat, këngët dhe zakonet familjare. Mund të krahasoni një dasmë të veriut me një dasmë të jugut, ose mënyrat e mikpritjes në zona të ndryshme.

Grupi C: Keqkuptime kulturore

Analizoni situata kur dallimet kulturore shkaktojnë keqkuptime. P.sh.: një nxënës tallet me dialektin e tjetrit, dikush nuk kupton pse një nxënës feston një festë të caktuar, ose paragjykon ushqimet tradicionale të zonës së dikujt tjetër. Diskutoni si mund të shmangen këto situata duke treguar respekt.

Kartolina Kulturore Shqiptare

Pasi keni studiuar rastin tuaj dhe punuar temën e përzgjedhur, krijoni një kartolinë kulturore ku të përfshini:

- një element të kulturës shqiptare që e përfaqëson;
- një fjali për rëndësinë e trashëgimisë kulturore;
- një mesazh respekti: "Respekto kulturën tënde dhe kulturat e të tjerëve, sepse secila prej tyre ka diçka të bukur për të treguar."

Varni kartolinat në murin e klasës, duke krijuar një "Hartë Kulturore Shqiptare".

"Debati në klasë" - Kultura dhe Diversiteti Kulturor

Pas prezantimeve, diskutoni:

- Cili ishte elementi kulturor më interesant?
- Si mund të shmangen paragjykimet kulturore?
- Si ju ndihmon njohja e kulturës të respektoni kulturat e tjera?
- A duhet të jetë kultura e një populli gjithmonë e pandryshueshme, apo mund të evoluojë me kohën? Pse?
- Çfarë ndodh kur njerëzit gjykojnë kulturat e tjera vetëm nga ajo që shohin në foto? A është kjo e drejtë?
- A mendoni se ushqimet tradicionale tregojnë diçka për historinë e një vendi? Pse po / pse jo?
- A është e mundur të kemi miqësi të forta mes njerëzve me kultura të ndryshme brenda Shqipërisë? Jepni shembuj.
- A mendoni se vizitat në muze dhe qytete historike na ndihmojnë të kuptojmë më mirë kulturën tonë? Pse?



- 1. Regjistroni në fletore disa të dhëna nga shokët dhe shoqet e klasës suaj (rreth 8 persona), për t'i patur kujtim në të ardhmen (p.sh., vendlindjen, hobi, parapëlqimet mbi festat, gatimet, muzikën, profesionet, natyrën etj.).**
- 2. Formoni me kompjuter një tabelë duke përdorur programin Excel ku të regjistroni të dhënat që mblodhët. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.**



Lexim plotësues. Faza e parë e projektit

Kultura dixhitale është mënyra se si ne përdorim teknologjinë në jetën e përditshme, si komunikojmë online, si kërkojmë informacion, si krijojmë përmbajtje dhe si sillet secili në botën virtuale. Teknologjia nuk është thjesht një pajisje, që mbajmë në duar, por pjesë e kulturës sonë: mënyra se si mësojmë, si lidhemi me njerëzit dhe si e shohim botën.

Teknologjia është bërë një shok i përditshëm.

Ajo ndihmon të mësojmë më shpejt, të komunikojmë me njerëz në çdo vend të botës, të gjejmë informacione shumë shpejt dhe të krijojmë ide të reja.

Por, si çdo mjet i fuqishëm, përdorimi i teknologjisë kërkon kujdes.

Përdorimi i tepërt ose i pakontrolluar i internetit mund të çojë në lodhje mendore, shpërqendrim, varësi, përhapje informacioni të pasaktë dhe sjellje të pahijshme online.

Në kulturën digjitale sot, ka rëndësi të dimë të zgjedhim informacionin e saktë, të njohim burimet e sigurta dhe të besueshme. Po aq e rëndësi ka të sillemi me përgjegjësi dhe respekt, njësoj si në jetën reale.

Në botën online gjurmët mbeten, dhe fjalët kanë peshë.

Teknologjia ka fuqi të madhe:

- Nëse e përdor mirë, mund të bësh dhe të arrish gjëra të mëdha.
- Nëse e përdor keq, mund të krijosh probleme për veten dhe të tjerët.

Kjo është arsyeja pse të kuptuarit e përfitimeve dhe rreziqeve është pjesë e kulturës digjitale moderne.

Përfitime të teknologjisë

1. Komunikim i shpejtë:

- Thirrje / video me familjarë jashtë vendit.
- Biseda në grupe për detyra shkolle.
- Mësim online kur nuk mund të jemi fizikisht në shkollë.

2. Mësim dhe kërkim:

- Përdorimi i platformave, si: Google Classroom, Quizlet.
- Gjetja e informacionit për projektet.
- Shikimi i videove edukative.

3. Argëtim dhe kreativitet:

- Krijim vizatimesh, posterash, video.
- Lojëra që zhvillojnë logjikën dhe strategjinë.
- Aplikacione për programim dhe robotikë.



Rreziqet e teknologjisë

1. Varësia nga telefoni / loja:

- Shpenzimi i orëve pa kuptim.
- Mospërqendrimi në mësim.

- Fjetja në orë të vona.

2. Informacioni i rremë (fake news):

- Besimi i gabuar tek lajme pa burime.

- Infomacione që nxisin frikë.

3. Rreziqet online:

- Fyerjet në rrjete sociale.
- Marrja e të dhënave personale.

- Aplikacione të pasigurta.

4. Shëndeti fizik:

- Dhimbje qafe, sy të lodhur, qëndrime të gabuara.
- Mungesë aktiviteti fizik.



Projekti në grupe

Çdo grup zgjedh **një titull kreativ**, p.sh.:

- "Teknologjia: Miku që të sfidon".
- "Online, por me mendje".
- "Bota virtuale në sytë e një adoleshenti".

1. Të përdorin **1 situatë reale**, si:

- Një nxënës që qëndron 6 orë në lojë – çfarë ndodh?
- Një video e rreme që u përhap në rrjet – si u besua?
- Një përvojë personale pozitive me teknologjinë (p.sh. mësim online gjatë pandemisë ose gripit).

2. Të përdorin **grafikë të thjeshtë**:

- Sa orë në ditë përdorin telefonin?
- Për çfarë e përdorin më shumë?

3. Pjesë reflektimi:

- "3 gjëra që dua të përmirësoj në përdorimin tim të teknologjisë."

Mjetet

- Kompjuter / Laptop
- PowerPoint
- Videoprojektor
- Internet
- Grafikë, foto nga puna e grupit

Mjedisi

Sallë ose klasë e organizuar që i lejon nxënësit të prezantojnë përpara klasës dhe të ftuarit të ndjekin projektet. Mund të vendoset një tavolinë për materialet shtesë të grupeve.

Metodologjia

- Diskutim
- Pyetje – përgjigje
- Prezantim me PowerPoint
- Vlerësim dhe vetëvlerësim
- Punë në grup

Veprimtaria e projektit

1. Prezantim me PowerPoint

Çdo grup paraqet projektin me 5 – 7 slide.

2. Renditja e prezantimeve

Sipas shortit ose sipas rendit të grupeve.

3. Pyetje dhe përgjigje

Nxënësit pyesin njëri-tjetrin.

Shembuj pyetjesh:

- Cila ishte pjesa më interesante?
- Cili rrezik të duket më i rëndësishëm?
- Cila ide për zgjidhje ishte më e mirë?

4. Vetëvlerësim i nxënësve

Nxënësi plotëson një fletë të shkurtër:

- Çfarë mësova?
- Ku mund të përmirësohem?
- Çfarë bëra mirë si pjesë e grupit?

5. Përfundimet e projektit

Diskutohen idetë kryesore që nxorën grupet.

6. Dokumentacioni final

Punimet dorëzohen si:

- PDF me e-mail
- Prezentim PowerPoint
- Postera të punuar me dorë



JI QYTETAR DIGJITAL I ZGJUAR!

Konfliktet dhe shkaqet e tyre

Adoleshenca është një periudhë e veçantë e jetës, ku fëmijët kalojnë ndryshime të mëdha fizike, emocionale dhe shoqërore. Në këtë moshë mendimet janë më të forta, ndjenjat përjetohen më intensivisht dhe dëshira për pavarësi është më e madhe.

Është e zakonshme që gjatë adoleshencës, të lindin më shpesh konflikte, pasi të rinjtë po mësojnë si të komunikojnë, si të shprehin ndjenjat dhe si të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme me të tjerët.

Konflikti shfaqet kur dy ose më shumë persona, nuk bien dakord për një mendim, një ndjenjë ose një situatë të caktuar. Shpesh, debatet ndihmojnë për të mësuar gjëra të reja, për të kuptuar më mirë veten dhe për të ndërtuar marrëdhënie më të forta, po pa arritur deri në konflikt. Konfliktet mund të shndërrohen në sjellje të dhunshme, mosmarrëveshje të zgjata dhe prishje të miqësive.

Fëmijët dhe adoleshentët nuk lindin të dhunshëm. Sjelljet e tyre ndërtohen nga mjedisi ku rriten, nga edukata që marrin në familje, mënyra si komunikojnë prindërit mes tyre, nga klima shoqërore dhe nga modeli që shohin. Një fëmijë që rritet në një familje ku prindërit zgjidhin mosmarrëveshjet me qetësi, ka më shumë mundësi të bëjë të njëjtën gjë. Ndërsa në një familje ku ka shumë zëra të lartë, ndëshkime të forta ose mungesë komunikimi, fëmija mund të ketë vështirësi për të kontrolluar emocionet ose për të zgjidhur konfliktet me fjalë.

Adoleshentët përjetojnë konflikte për shumë arsye. Një shembull i thjeshtë: dy shokë zihen për një lojë në internet, sepse njëri nuk pranon humbjen, ose sepse dikush ka komentuar diçka pa menduar. Një tjetër shembull është kur një nxënës ndihet i përjashtuar nga grupi i klasës, gjë që krijon tension dhe pakënaqësi. Madje edhe situatat që duken të vogla, si: përdorimi i telefonit gjatë orës së mësimi, konkurrenca për notat ose për vëmendje mund të kthehen në konflikte, nëse nuk flitet hapur për to.

Shkaqet më të zakonshme të konflikteve në adoleshencë janë keqkuptimet, paragjykimet, xhelozitë, reagimet e nxituara dhe mungesa e komunikimit.

Kur adoleshentët e mbajnë gjithçka brenda vetes, kur nuk ndajnë dot shqetësimet ose kur nuk i shprehin ndjenjat e tyre, konfliktet bëhen më të forta. Të mësuarit se si të komunikojnë me qetësi, si të kërkojnë ndihmë dhe si të vendosin kufij të duhur, është pjesë e rritjes dhe një aftësi shumë e rëndësishme për jetën.

Konfliktet janë pjesë e marrëdhënieve njerëzore. Ajo që ka rëndësi është si i menaxhojmë. Duke kuptuar shkaqet e konflikteve dhe duke ushtruar aftësitë e komunikimit, adoleshentët ndërtojnë personalitet të fortë, marrëdhënie të shëndosha dhe respekt për të tjerët.



Konfliktet dhe Dallimet Kulturore



Në shoqërinë ku jetojmë, njerëzit kanë mënyra të ndryshme jetese, tradita të ndryshme dhe zakone që vijnë nga kultura të ndryshme. Këto dallime e bëjnë botën më të larmishme dhe më interesante. Megjithatë, pikërisht këto dallime mund të sjellin keqkuptime dhe konflikte midis njerëzve.

Për shembull, në Shqipëri, në zona të ndryshme gjejmë mënyra të ndryshme të folurit, veshje tradicionale të veçanta ose mënyra të ndryshme

festimi. Këto janë pjesë të bukura të kulturës sonë, por nëse nuk i kuptojmë dhe nuk i respektojmë, mund të lindin përplasje të panevojshme.

Shpesh, konfliktet lindin pikërisht nga dallimet që ekzistojnë midis nesh - mënyra si flasim, si vishemi, çfarë mendojmë, cilat tradita ndjekim apo nga cilat familje vijmë.

Në komunitetin shqiptar ka shumë shembuj pozitivë që tregojnë se njerëzit nga kultura të ndryshme mund të gjejnë gjuhën e përbashkët.

Në shumë qytete shqiptarët urojnë njëri - tjetrin për festa të ndryshme, edhe kur nuk i festojnë vetë. Në disa shkolla, fëmijë nga zona të ndryshme (me tradita, dialekte, kultura familjare të ndryshme) ndërveprojnë më së miri së bashku në projekte dhe punë në grup. Këto janë prova se respekti dhe bashkëjetesa janë vlera të forta të kulturës sonë.

Por ka raste kur dallimet kulturore krijojnë mosmarrëveshje.

Një nxënës mund të tallet me komunnikimin e dikujt tjetër; një shok mund të mos e kuptojë pse dikush feston një festë të caktuar; një nxënës ndonjëherë ndjehet i përjashtuar sepse vjen nga një zonë apo kulturë tjetër. Prandaj, është shumë e rëndësishme që nxënësit të mësojnë të njohin dhe të vlerësojnë kulturat që i rrethojnë.

Ata duhet të edukohen që të mos gjykojnë, por të pyesin, të mos tallen, por të kuptojnë. Të mos largohen nga ndryshimet, por t'i shohin ato si mundësi për të mësuar diçka të re. Vetëm kështu krijohet mjedis i mirë, i sigurt. Të gjithë ndihen të pranuar dhe të respektuar. Përveç të kuptuarit të konflikteve, ka rëndësi të zhvillohet modeli për zgjidhjen e tyre.

Kur lind konflikti, nxënësi duhet të përpiqet:

- të flasë qetë dhe të dëgjojë tjetrin.
- të kuptojë se cilat ndjenja përjetohen.
- të sqarohet dhe të shmangë reagimet e shpejta.
- të pranojë gabimin kur ka gabuar.
- të gjejë një zgjidhje të mirë për të dy.

Nëse dy nxënës zihen, sepse njëri mendon se tjetri e ofendoi, para se të reagojë, ai mund të pyesë: "Kishe diçka me mua?" Mbase ishte keqkuptim, dhe problemi zgjidhet menjëherë. Shoqet zihen për një vend në bankë, por të bisedojnë qetësisht, mund të gjejnë zgjidhje. Konflikti nuk është fundi i miqësisë, nëse zgjidhet me respekt, mund të forcojë marrëdhëniet.



Shkaqet që sjellin konflikte janë:

1. *Keqkuptimet*: Adoleshentët shpesh nxiten nga informacioni i gabuar dhe nuk pranojnë të diskutojnë apo dëgjojnë njëri - tjetrin për të vërtetën.
2. *Interesa të ndryshme*: Në raste të veçanta dy ose më shumë persona dëshirojnë të njëjtën gjë, por kanë mendime të ndryshme për një situatë të caktuar.
3. *Paragjykimet dhe stereotipet*: Gjykimi pa e njohur shokun dhe diskriminimi, të çojnë në konflikt.
4. *Mungesa e komunikimit*: Mbyllja në vetevete nuk mundëson shprehjen e ndjenjave dhe i bën adoleshentët të mos flasin për problemet që i shqetësojnë.
5. *Xhelozia dhe konkurrenca*: Krahësimi me njëri - tjetrin dhe dëshira për të fituar gjithmonë, janë veprime që sjellin ndjenja agresive.

**Veprimtari në klasë – Lojë me role: “Respekto shokun!”**

Nxënësit punojnë në grupe dyshe për të plotësuar tabelën e mëposhtme.

Konflikti	Shkaku
Zënkë mes shokësh	
Grindje në familje	
Bullizimi në rrjete sociale	
Grindje për kohën e kaluar në telefon	
Ndjenja e ankthit për shkollën	
Nxënës që nuk zbatojnë rregulloren e klasës	
Nxënës që ndjehet i përjashtuar	

**Pyetje për diskutim**

1. Përkufizo konceptin “konflikt”.
2. Pse familja është e rëndësishme në formimin tonë?
3. Përshtkruaj faktorët që sjellin konflikte.
4. Dallo shkaqet e konflikteve në adoleshencë.
5. **Detyrë:** Përshtkruaj një situatë konflikti që ke përjetuar dhe diskuto shkaqet e tij.

**Fjalor**

Diskriminim - quajmë trajtimin e padrejtë të një personi, vetëm sepse ai është ndryshe nga të tjerët. Ky trajtim i pabarabartë mund të ndodhë për shkak të: kulturës, fesë, gjuhës apo dialektit, pamjes së jashtme, prejardhjes familjare, aftësive fizike ose mendore, zgjedhjeve personale.

1. Konfliktet dhe roli i shkollës

Mësuam që konflikti është një situatë kur dy ose më shumë persona nuk bien dakord për diçka, kanë mendime të ndryshme, ose reagojnë ndryshe ndaj të njëjtës sjellje. Konfliktet ndodhin kudo: në klasë, në familje, në lagje dhe madje edhe online.

Në jetën e përditshme, sidomos në një shoqëri me kultura dhe nënkultura të ndryshme, ndodh që njerëzit të kenë qëndrime të ndryshme ndaj një sjelljeje apo ngjarjeje. Këto dallime kulturore mund të çojnë në keqkuptime.

Në disa familje flitet me zë të lartë gjatë bisedës, kjo është diçka normale për ata, ndërsa në familje të tjera, kjo shihet si mungesë edukate.

Kjo sjellje mund të keqkuptohet dhe të kthehet në konflikt midis fëmijëve që vijnë nga familje të ndryshme.

Nxënësit duhet të aftësohen të dallojnë kur një konflikt lind pikërisht për shkak të këtyre dallimeve, që shpesh nuk janë me qëllim të keq. Prandaj, njohja e kulturave të ndryshme dhe respekti për to është hapi i parë drejt parandalimit të konflikteve.

Shkolla ka rol shumë të rëndësishëm në këtë proces. Ajo është mjedisi ku adoleshentët mësojnë jo vetëm lëndët mësimore, por edhe vlerat shoqërore, si: komunikimi, dëgjimi aktiv, mirëkuptimi dhe zgjidhja e qetë e mosmarrëveshjeve.

Për këtë arsye, shkolla ka struktura të posaçme që ndihmojnë në ruajtjen e rendit dhe në menaxhimin e konflikteve.

2. Strukturat që ndihmojnë në zgjidhjen e konflikteve në shkollë

I. Mësuesi kujdestar

Mësuesi kujdestar është personi që ndjek çdo ditë atmosferën e klasës dhe ndihmon në ruajtjen e një klime të qetë, të sigurt dhe bashkëpunuese. Ai informon prindërit dhe nxënësit për rregullat, vlerat dhe detyrimet e tyre. Mësuesi kujdestar është i pari që dëgjon problemet e nxënësve dhe i ndihmon të qetësohen dhe të kuptojnë gabimet.

II. Shërbimi psiko-social

Psikologu dhe punonjësi social i shkollës ndihmojnë nxënësit që kanë vështirësi emocionale, probleme familjare, ndjesi përjashtimi ose konflikte të përsëritura. Ata i orientojnë fëmijët të shprehin ndjenjat me fjalë, të njohin emocionet dhe t'i zgjidhin problemet pa dhunë.

III. Oficeri i sigurisë

Ky person kujdeset për sigurinë e të gjithë nxënësve dhe ndërhyr kur ka sjellje të rrezikshme. Ai i mëson fëmijëve rëndësinë e ligjit, rregullave dhe përgjegjësitë.



3. Të dallojmë shkaqet, pasojat dhe mënyrat e parandalimit

Nxënësit duhet të zgjerojnë aftësinë për të dalluar rastet e konflikteve dhe shkaqet e tyre. Shkaqet e konflikteve mund të jenë:

- keqkuptime të thjeshta;
- interesat e ndryshme;
- paragjykimet;
- presioni i shoqërisë;
- mungesa e komunikimit;
- ndjenjat e xhelozisë ose padrejtësisë;
- dallimet kulturore ose nënkulturore.

Pasojat e konflikteve, nëse nuk trajtohen, prekin individin dhe shoqërinë:

- prishje e miqësisë;
- ndjenjë vetmie ose izolimi;
- përkeqësim i atmosferës në klasë;
- ulje e sigurisë;
- rritje e sjelljeve të dhunshme.

Nxënësit duhet të marrin pjesë aktive në sugjerimin e mënyrave të parandalimit, si:

- përdorimi i fjalëve të qeta,
- dëgjimi me vëmendje,
- kërkimi i sqarimit,
- pranimi i gabimit,
- respektimi i kulturave dhe sjelljeve të ndryshme.



Falja, mbyllja e konfliktit



- **Kërkoni në internet podcast-e apo video me të dhëna zyrtare e shkencore mbi aktivitetet sociale në tri shkolla shqiptare të qyteteve të ndryshme. Bëni një përmbledhje me faktet më të veçanta që mësuat. Mos harroni të citoni burimin e informacionit.**

4. Hapat për trajtimin dhe zgjidhjen e një konflikti

Mund të përdorni një model të thjeshtë me hapa, që mund ta zbatoni gjithmonë edhe në situata jashtë shkollës:

- a. Ndalo dhe qetësohu.
Mos u përgjigj me nervozizëm. Merr frymë dhe qetësohu.
- b. Dëgjo tjetrin.
Lëre tjetrin të shpjegojë çfarë ka ndodhur. Mos e ndërprit.
- c. Shpjego ndjenjat e tua.
Trego me fjalë si je ndier: “U ndjeva keq kur the ato fjalë...”.
- d. Kupto që është keqkuptim.
Pyet: “A e kishe me mua? Mund ta sqarojmë?”
- e. Kërko falje ose prano faljen.
Nëse ke gabuar, kërko falje. Nëse tjetri kërkon falje, pranoje.
- f. Gjeni një zgjidhje së bashku.
Vendosni çfarë do të bëni për të mos përsëritur konfliktin.
- g. Kërko ndihmë kur është e nevojshme.
Mësuesi kujdestar, psikologu, ose oficeri i sigurisë, janë aty për t’ju ndihmuar.

5. Shembuj praktikë të lidhur me kulturën

Shembull 1 – Keqkuptim kulturor në klasë

Dy nxënës konfliktohen sepse njëri tallet me veshjen e tjetrit. Kujdestari i shpjegon klasës se mënyra e të veshurit është pjesë e kulturës dhe se veprimi i tyre është diskriminues. Nxënësit mësojnë të vlerësojnë larminë.

Shembull 2 – Dallime në zakon familjar.

Një nxënës refuzon të marrë pjesë në një aktivitet, sepse familja e tij ndjek një traditë ndryshe. Shokët nuk e kuptojnë dhe lind konflikt. Psikologu i shkollës shpjegon se familjet kanë zakone të ndryshme kulturore dhe duhet mirëkuptim.



Pyetje për diskutim

1. Cili është roli i shkollës sot?
2. Pse shoqëria ka nevojë për modelin e shkollës?
3. Cilat janë strukturat që zgjidhin konfliktet në shkollë?
4. Përshkruaj rolin e mësuesit kujdestar, shërbimit psiko-social dhe oficerit të sigurisë.
5. **Detyrë:** Përshkruaj rolin e shkollës tënde në zgjidhjen e konflikteve.



Fjalor

Nënkulturë - një grup njerëzish brenda një shoqërie, të cilët kanë zakone, sjellje, veshje, të folur, interesa ose tradita të veçanta, që i dallojnë nga pjesa tjetër e komunitetit. Edhe pse janë pjesë e së njëjtës shoqëri, ata kanë disa veçori kulturore që i bashkojnë si grup.

2.1

ÇFARË ËSHTË KOMUNITETI?

Komuniteti është një bashkësi njerëzish që jetojnë ose veprojnë në të njëjtën hapësirë dhe që ndajnë interesa, rregulla, përgjegjësi dhe qëllime të përbashkëta.

Ai krijohet përmes bashkëjetesës dhe bashkëpunimit të njerëzve, të cilët përpiqen të organizojnë jetën e përditshme në mënyrë sa më të drejtë dhe të rregullt. Në një komunitet, secili individ ka vendin dhe rolin e vet, duke kontribuar në funksionimin e tij.

Çdo njeri është pjesë e disa komuniteteve njëkohësisht. Që nga familja dhe klasa, deri te lagjja, shkolla dhe qyteti. Komunitetet ju ndihmojnë të mësoni si të bashkëjetoni me të tjerët. Aty mësoni të respektoni mendime të ndryshme, të ndihmoni njëri - tjetrin dhe të kuptoni rëndësinë e veprimit për të mirën e përbashkët.



Lexim

Unë jetoj në një pallat në Tiranë. Edhe pse pallati është i ri, çdo ditë vërej se ashensori, shkallët dhe hapësirat e përbashkëta, kanë nevojë për kujdes dhe mirëmbajtje. Për këtë arsye, banorët u mblodhën dhe zgjodhën Këshillin e Pallatit dhe një Administrator. Ata do kujdesen për rregullin, pastërtinë dhe zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Njerëzit, po të bashkëpunojnë në komunitet, kanë për ta përmirësuar jetën e përditshme.

Po ju?

1. A keni vërejtur probleme në lagjen ku ju banoni?
2. Si është vepruar nga banorët për zgjidhjen e tyre?



Rregullat në komunitet

Rregullat janë thelbësore për funksionimin e çdo komuniteti. Ato ndihmojnë që njerëzit të dinë se si duhet të sillen në familje e shoqëri. Falë rregullave, jeta në komunitet bëhet më e qetë, më e sigurt dhe më e organizuar.

Në mungesë të rregullave, shpesh lindin keqkuptime dhe konflikte. Për këtë arsye, rregullat duhet që të respektohen nga të gjithë anëtarët e komunitetit. Në komunitetin e klasës, për shembull, rregullorja ju mëson të dëgjoni shokun, shoqen, të respektoni mësuesit dhe të mbani pastër mjedisin, duke krijuar një klimë të mirë për mësim.

Të drejtat dhe detyrat në komunitet


Çdo anëtar i komunitetit ka të drejta dhe detyra, që duhet t'i respektojë. Të drejtat u japin njerëzve mundësinë të shprehin mendimet e tyre, të dëgjohen dhe të trajtohen me barazi dhe respekt. Ato janë të rëndësishme sepse krijojnë ndjenjën e drejtësisë dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive në komunitet. Detyrat, ju mësojnë përgjegjësitë që keni dhe bashkëpunimin. Duke zbatuar detyrat tuaja, ju ndihmoni në ruajtjen e rregullit dhe të mirave të përbashkëta. Respektimi i rregullave, kryerja e detyrave, kujdesi për mjedisin, janë shembuj konkretë të detyrave në komunitet.



1. Kërkoni në fjalorin online përkufizimin e fjalëve: “bashkësi”, “interesa”, “bashkëjetesë”, “thelbësor”. Shkruani në fletore përkufizimet e tyre, duke u përpjekur që të kujtoni saktë kuptimin. Matni kohën e procesit dhe regjistroni në fletore.
2. Shkruani me kompjuter përkufizimin e fjalëve më lart. Matni kohën e procesit dhe regjistroni në fletore.

Si funksionon komuniteti?

Skema paraqet elementet kryesore që e bëjnë komunitetin të funksionojë. Në qendër ndodhet komuniteti, ndërsa përreth tij janë mënyrat se si njerëzit bashkëpunojnë për të jetuar më mirë së bashku. Kjo skemë tregon se komuniteti ecën më mirë, falë **bashkëpunimit** të disa elementeve kryesore, të cilat lidhen mes tyre. Në qendër ndodhet komuniteti, ndërsa përreth tij paraqiten katër mënyra kryesore se si njerëzit jetojnë dhe veprojnë së bashku, për të krijuar mjedis të rregullt dhe të sigurt.



Zgjidhja e problemeve është e domosdoshme, sepse në çdo komunitet lindin vështirësi të ndryshme, si: mungesa e pastërtisë apo keqkuptimet mes njerëzve. Kur anëtarët diskutojnë dhe bashkëpunojnë për të gjetur zgjidhje, komuniteti bëhet më i fortë dhe më i organizuar. Edhe fëmijët ndihmojnë duke dhënë ide dhe duke respektuar rregullat.

Shërbimet, janë tjetër element i rëndësishëm i komunitetit. Ato përfshijnë: pastrimin, mirëmbajtjen e hapësirave publike, shkollat, qendrat shëndetësore dhe transportin. Kur shërbimet funksionojnë mirë dhe përdoren me përgjegjësi, jeta e përditshme bëhet më e lehtë dhe komuniteti zhvillohet.

Mundësitë e komunikimit, u japin njerëzve idetë si të shprehin mendimet, shqetësimet dhe vizionin e tyre. Komunikimi i hapur dhe me respekt, ndihmon në zgjidhjen e problemeve dhe shmang keqkuptimet, si në lagje ashtu edhe në klasë.

Një komunitet funksional ka nevojë për zgjidhje problemesh, shërbime të mira, komunikim dhe bashkëveprim.

Roli i fëmijëve në komunitet

Fëmijët kanë rol shumë të rëndësishëm në komunitet, sepse ata janë e ardhmja e tij. Që në moshë të vogël, ata mësojnë si të bashkëjetojnë me të tjerët, të respektojnë rregullat dhe të sillen me përgjegjësi. Sjellja e mirë e fëmijëve ndikon drejtpërdrejt në krijimin e një mjedisi pozitiv.

Duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe në lagje, fëmijët mësojnë vlerat e bashkëpunimit dhe solidaritetit. Kur fëmijët rriten me parime të shëndetshme, ata kontribuojnë në ndërtimin e një komuniteti më të drejtë dhe më të bashkuar.



Pyetje për diskutim

1. Çfarë është komuniteti?
2. Pse janë të rëndësishme rregullat në komunitet?
3. Cili është ndryshimi ndërmjet të drejtave dhe detyrave?
4. Pse është i rëndësishëm roli i fëmijëve në komunitet?
5. Detyrë: Përshkruani disa probleme që vëreni në shkollën tuaj dhe jepni mendime për mënyrën e zgjidhjes së tyre. A merr pjesë komuniteti së bashku me prindërit dhe mësuesit, për funksionimin sa më të mirë të shkollës tuaj?



Fjalor

Kontribuoj - do të thotë të japësh ndihmesë, të marrësh pjesë ose të ofrosh diçka (kohë, punë, ide, para apo përpjekje) për arritjen e një qëllimi të përbashkët ose për të ndihmuar dikë apo diçka.

Solidaritet - është ndjenja dhe veprimi i mbështetjes, ndihmës dhe bashkimit me të tjerët, sidomos kur ata kanë nevojë ose përballen me vështirësi.

Sipas rolit dhe fushës ku veprojnë në jetën e përditshme, dallojmë komunitete të ndryshme. Më poshtë janë disa shembuj tipikë që i hasim shpesh:



Komuniteti i biznesit

Kush bën pjesë: të gjithë biznesmenët dhe punonjësit që zhvillojnë veprimtari ekonomike në vendin tone.

Roli i tij është zhvillimi ekonomik, krijimi i vendeve të punës dhe ofrimi i shërbimeve dhe produkteve për shoqërinë. Kur bizneset punojnë sipas rregullave, ato kontribuojnë në mirëqenien e komunitetit: mbajnë të punësuar njerëz, paguajnë taksa dhe shpesh, mbështesin nisma sociale në lagje apo në qytet.



Komuniteti i shkollës

Kush bën pjesë: prindër, nxënës, stafi pedagogjik, sanitare, shërbimi psiko - social, oficerët e sigurisë dhe punonjës të tjerë të shkollës. **Roli:** mbarëvajtja e procesit mësimor dhe krijimi i një mjedisi të sigurt e të respektueshëm për nxënësit.

Në komunitetin e shkollës, secili ka një detyrë: mësuesit, të mësojnë nxënësit; nxënësit të respektojnë rregullat dhe të bashkëpunojnë në klasë; ndërsa prindërit të mbështesin procesin mësimor dhe të marrin pjesë në vendimmarrje për çështje të rëndësishme.



Komuniteti familjar

Kush bën pjesë: prindër, fëmijë, gjyshër, halla, teze, xhaxhallarë dhe të afërm të tjerë.

Roli: mbështetja, dashuria, kujdesi dhe edukimi qytetar për jetën. Familja është komuniteti i parë ku mësojmë të flasim me respekt, të ndihmojmë, të ndajmë përgjegjësi dhe të kuptojmë se veprimet tona ndikojnë te të tjerët, te shoqëria.



Komuniteti fetar

Kush bën pjesë: besimtarët, klerikët, ndihmës të tyre në institucionet e ndryshme fetare.

Roli: ruajtja e traditave shpirtërore dhe promovimi i vlerave morale, si: respekti, paqja dhe solidariteti. Komunitetet fetare nxisin bashkëjetesën dhe tolerancën.



Komuniteti sportiv

Kush bën pjesë: individë që merren me sporte të ndryshme, trajnerë, ekipe sportive dhe tifozë. **Roli:** promovimi i edukimit sportiv, shëndetit dhe punës në ekip. Sporti na mëson disiplinën, respektin për rregullat dhe bashkëpunimin. Përmes sportit, njerëzit lidhen me njëri - tjetrin dhe krijojnë miqësi, edhe kur janë nga lagje apo shkolla të ndryshme. Ne kemi një shembull të shkëlqyer: Luiza Gega. Atlete shumë e talentuar dhe e palodhur. Ajo mban rekordin në vrapimin 800, 1500 dhe 3000 metra. Në vitin 2022 u bë kampione e re e Europës në atletikë, medalje e artë në 3000 m. me pengesa.



Kampionia: Luiza Gega

Klasifikimi i komuniteteve

Komunitetet mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme, në varësi të këndvështrimit nga i cili i studiojmë. Në këtë temë do të përdorim dy mënyra klasifikimi, të cilat nuk kundërshtojnë njëra - tjetrën, por na ndihmojnë ta kuptojmë konceptin.

1 Klasifikimi sipas mënyrës së formimit dhe organizimit

Sipas mënyrës se si krijohen dhe si funksionojnë, komunitetet ndahen në tri grupe: komunitete natyrore, komunitete shoqërore dhe komunitete institucionale.

Komunitetet natyrore janë ato ku njeriu bën pjesë që në lindje, familja. Komunitetet shoqërore krijohen nga njerëz që bashkohen për interesa dhe qëllime të përbashkëta, si: klasa ose grupi i shokëve. Komunitetet institucionale janë të organizuara dhe funksionojnë sipas rregullave e ligjeve: shkolla, bashkia, spitali etj.

2 Klasifikimi në kuptimin gjeografik dhe në kuptimin social-ekonomik

Në kuptimin gjeografik, komuniteti lidhet me një hapësirë të caktuar ku jetojnë njerëzit, si: qyteti, fshati ose rajoni. Këtu anëtarët e komunitetit i bashkon vendi ku jetojnë dhe problemet apo nevojat e përbashkëta të asaj zone.

Në kuptimin social dhe ekonomik, komuniteti lidhet me një grup njerëzish që i bashkojnë interesa shoqërore dhe ekonomike, si: komuniteti i biznesit, komuniteti i sportit ose komunitete të tjera që krijohen për qëllime të përbashkëta.

Komuniteti i shkollës është edhe komunitet shoqëror (njerëz që bashkohen për edukim), por edhe komunitet institucionale (sepse është institucion i organizuar me rregulla).



Pyetje për diskutim

1. Çfarë është komuniteti dhe pse është i rëndësishëm për jetën e njerëzve?
2. Cilat janë llojet kryesore të komuniteteve? Jep nga një shembull për secilin.
3. Si klasifikohen komunitetet sipas mënyrës së formimit dhe organizimit?
4. Si klasifikohen komunitetet në kuptimin gjeografik dhe social-ekonomik?
5. Çfarë i bashkon individët në një komunitet?
6. Detyrë: Bashkia e qytetit vendosi të ndërtojë një shkollë të re. Specialistet e urbanistikës hartuan 2 projekte që do të diskutoheshin me komunitetin e prindërve të shkollës. Në takim, shumë prindër dhanë mendimet e tyre. Specialistët morën parasysh sygjerimet e tyre. Cilat komunitete u përfshinë në këtë situatë?

Çfarë janë shërbimet në komunitet

Shërbimet në komunitet janë ndihma dhe veprimtari që u ofrohen njerëzve për të përmirësuar jetën e përbashkët në një lagje, fshat apo qytet. Ato bëjnë të mundur që komuniteti të funksionojë normalisht dhe që çdo qytetar të ndihet i sigurt, i mbrojtur dhe i përkrahur.

Në jetën e përditshme, ju përfitoni nga shërbimet në komunitet edhe pa e kuptuar.

Për shembull, në mëngjes rrugët janë të pastruara, shkolla hap dyert për nxënësit, një mjek ju pret në qendrën shëndetësore dhe ju kuptoni se të gjitha këto janë shërbime.

Ato ekzistojnë për të mirën e përbashkët. Shërbimet në komunitet bazohen në bashkëpunim, solidaritet dhe përgjegjësi.

Ato tregojnë se njerëzit nuk jetojnë të ndarë, por bashkëpunojnë për të jetuar më mirë.

Shërbimet shëndetësore në jetën e përditshme

Shërbimet shëndetësore janë ndër më të rëndësishmet në komunitet. Spitalet, qendrat shëndetësore, ambulancat, mjekët dhe infermierët kujdesen çdo ditë për shëndetin e njerëzve. Një shembull i thjeshtë nga jeta e përditshme, është që fëmijët shkojnë te mjeku për një kontroll, për t'u vaksinuar etj. Kur një nxënës sëmurët në shkollë dhe mësuesit lajmërojnë prindërit ose thërrasin ndihmën mjekësore, shërbimi shëndetësor ndërhyr për të mbrojtur shëndetin e fëmijës. Në raste më të rënda, ambulanca vjen në kohë për të transportuar të sëmurin në spital. Edhe marrja e ilaçeve në farmaci me këshillën e mjekut, kujdesi për të moshuarit që nuk mund të lëvizin vetë, janë pjesë e shërbimeve shëndetësore që e bëjnë jetën më të sigurt.



Shërbimet e sigursë dhe mbrojtjes

Një tjetër shtyllë e rëndësishme e komunitetit janë shërbimet e sigursë. Policia, zjarrfikësit dhe shërbimet e trafikut, punojnë për rendin dhe mbrojtjen e qytetarëve. Kur një polic ndihmon nxënësit të kalojnë rrugën pranë shkollës, ai po mbron jetën e tyre dhe ofron një shërbim të rëndësishëm.


Zjarrfikësit ndërhyjnë kur ka zjarr në një shtëpi, pallat apo pyll. Një zjarr i vogël mund të kthehet në rrezik të madh nëse nuk ndërhyjnë në kohë zjarrfikësit. Shërbimet e trafikut, vendosin tabela dhe sinjalistikë rrugore, për të parandaluar aksidentet dhe për qarkullimin. Në jetën e përditshme, shërbimet e sigursë ju ndihmojnë të ndiheni më të qetë dhe të mbrojtur.



1. Kërkoni në internet me fjalët kyçe: “adresë zyrtare shërbime komuniteti Shqipëri”.
Për çfarë bëhet fjalë?
2. Cilat faqe do të përdornit për të shkruar një historik të shkurtër mbi shërbimet në komunitetin tuaj? A janë ato faqe zyrtare?
3. Shkruani në fletore një shkrim të shkurtër mbi shërbimet në komunitetin tuaj (10-15 fjali), ku të përmendni tri veçanti që ju tërheqin.

Shërbimet publike dhe roli i bashkisë

Shërbimet publike janë ato që ndikojnë drejtpërdrejt në mjedisin ku jetoni. Bashkia kujdeset për furnizimin me ujë, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, pastrimin e qytetit dhe gjelbërimin. Një shembull i zakonshëm është kur një rrugë e dëmtuar riparohet ose kur mbillen pemë dhe lule në lagje. Pastrimi i mbeturinave, vendosja e koshave ndihmon në mbajtjen e mjedisit të pastër dhe të shëndetshëm. Kur bashkia ndërton kënde lojërash ose rregullon parqet, ajo krijon hapësira të sigurta, ku fëmijët mund të luajnë dhe të njihen. Këto shërbime e bëjnë komunitetin të organizuar dhe më të këndshëm.



Shërbimet arsimore dhe rëndësia e tyre

Shërbimet arsimore janë shumë të afërta me jetën e nxënësve. Shkolla, mësuesit, bibliotekat dhe libraritë janë institucione që ndihmojnë fëmijët të mësojnë dhe të zhvillohen. Kur nxënësit përdorin bibliotekën për të lexuar libra ose për të bërë detyrat, ata po përfitojnë nga një shërbim arsimor. Në shkollë, nxënësit mësojnë jo vetëm mësimet, por edhe rregulla respekti dhe bashkëpunimi. Aktivitetet në grup, projektet dhe veprimtaritë shkollore i përgatisin fëmijët për jetën në komunitet.



Roli i qytetarëve në komunitet

Shërbimet në komunitet nuk varen vetëm nga institucionet, por edhe nga vetë qytetarët. Një shembull konkret është kur banorët e një pallati bashkëpunojnë për të mbajtur mjediset e përbashkëta të pastra. Po ashtu, kur nxënësit ndihmojnë një shok klase që ka vështirësi në mësim, ata tregojnë solidaritet. Respektimi i rregullave, kujdesi për mjedisin dhe ndihma ndaj të tjerëve, janë mënyra të thjeshta për të kontribuar në komunitet dhe për ta bërë atë më të mirë.



Pyetje për diskutim

1. Çfarë janë shërbimet në komunitet dhe pse janë të rëndësishme?
2. Jepni disa shembuj shërbimesh që përdorni çdo ditë.
3. Cili shërbim mendoni se ndihmon më shumë komunitetin tuaj? Pse?
4. Si mund të ndihmoni ju si nxënës për ta përmirësuar komunitetin ku jetoni?
5. Veprimtari në klasë: Nxënësit ndahen në 5 grupe. Çdo grup përshkruan një shërbim në komunitet dhe jep shembuj nga jeta e përditshme, duke i paraqitur para klasës.

Komuniteti urban (qyteti)

Në komunitetin urban jeton një numër i madh njerëzish dhe jeta zhvillohet me ritëm të shpejtë. Qytetet karakterizohen nga pallate të larta, rrugë të mbushura me makina dhe një trafik i rënduar, sidomos në orët e mëngjesit dhe të pasdites. Shumë njerëz lëvizin çdo ditë për në shkollë, punë apo për të kryer shërbime të ndryshme. Në qytet ka shumë institucione dhe shërbime, si: shkolla të mëdha, spitale, bashki, polici, biblioteka, qendra sportive dhe kulturore. Nxënësit shkojnë në shkollë me autobus ose në këmbë. Familjet blejnë në dyqane dhe supermarkete, ndërsa qytetarët përdorin shërbime të ndryshme publike. Megjithëse qyteti ofron shumë mundësi, njerëzit shpesh nuk njihen mirë mes tyre. Jeta është e vullshme dhe kontakti i banorëve është më i kufizuar. Profesione të ndryshme në komunitetin urban janë kryesisht nga sektori i shërbimeve, si: mjekë, mësues, punonjës administrate, tregtarë apo punonjës të transportit.



Komuniteti rural (fshati)

Në komunitetin rural jeton një numër më i vogël njerëzish dhe banesat janë kryesisht shtëpi private. Jeta në fshat është më e qetë dhe më e lidhur me natyrën. Njerëzit zgjohen herët dhe dita shpesh lidhet me punët në bujqësi, kujdesin për kafshët ose punë të tjera. Në fshat, njerëzit njihen mirë mes tyre, marrëdhëniet mes fqinjëve janë më të afërta. Ndiqma është e zakonshme, sidomos në punët sezonale ose në raste vështirësish. Për shembull, banorët ndihmojnë njëri - tjetrin në korje, në ndërtim banesash ose në organizimin e aktiviteteve tradicionale. Shërbimet në komunitetin rural mund të jenë më të pakta se në qytet. Shkolla, qendra shëndetësore dhe bashkia janë institucione të rëndësishme edhe në fshat, sepse sigurojnë shërbime bazë për banorët.





Elda kishte ardhur me banim nga një zonë rurale në qytet dhe ishte regjistruar në një shkollë të madhe, me shumë klasa dhe një numër të madh nxënësish. Ditët e para për të ishin të mbushura me emocione dhe përshtypje të reja. Shkolla ishte më e madhe, korridoret më të zhurmshme dhe ritmi i ditës shumë më i shpejtë se në shkollën e vogël të fshatit, ku kishte mësuar më parë.

Pas disa javësh, Elda ishte bashkë me nënën e saj në takimin që shkolla zhvillonte me prindërit. Në këtë takim u diskutuan disa çështje, që lidhen me jetën shkollore. Një ndër problemet kryesore ishte numri i madh i nxënësve të sëmurë me virozë në klasë. Prindërit shprehën shqetësimin e tyre dhe mësuesit folën për masat që duhej të merren.

Ky diskutim i bëri shumë përshtypje Eldës, sepse në shkollën e saj në fshat, virozat nuk kishin qenë shqetësim i madh. Ajo kujtoi ambientin e hapur, ajrin e pastër dhe numrin e vogël të nxënësve në klasë. Për herë të parë kujtoi se jeta në qytet dhe jeta në fshat kishin ndryshime dhe se çdo komunitet kishte veçoritë dhe sfidat e veta.

1. Pse Eldës i bëri përshtypje diskutimi i prindërve në takim?
2. Cilat mund të jenë shkaqet e rritjes së virozave në komunitete të mëdha urbane?

Dallimet mes komunitetit urban dhe rural

Komuniteti urban dhe ai rural dallojnë në mënyrën e jetesës, mjedisin, marrëdhëniet shoqërore dhe llojin e profesioneve.

Në qytet jeta është më e vullshme, jetojnë shumë njerëz në një hapësirë të kufizuar dhe ka lëvizje të vazhdueshme.

Qytetet kanë shumë shërbime dhe institucione, por edhe më shumë zhurmë, ndotje dhe trafik. Në qytet njerëzit presin në radhë për shërbime, përdorin transportin publik dhe jetojnë në pallate, ku ndajnë hapësira të përbashkëta me shumë familje të tjera.

Në fshat, jeta është më e qetë dhe ritmi i përditshëm është më i ngadaltë.

Ajri është më i pastër dhe njerëzit dalin shumë në natyrë ose në punë që lidhen me tokën dhe kafshët. Marrëdhëniet janë më të afërta, sepse banorët njihen mirë dhe ndihma mes fqinjëve është e zakonshme.

Edhe mënyra e organizimit të jetës së përditshme ndryshon. Në qytet, njerëzit



1. Merrni pranë një orë ose pajisje digjitale dhe matni kohën që ju duhet për të kopjuar në fletore dy paragrafët e fundit të leximit.
2. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.

ndjekin orare të rrepta pune dhe shërbimesh, ndërsa në fshat puna shpesh lidhet me stinët dhe kushtet natyrore.

Këto dallime ndikojnë në mënyrën se si fëmijët rriten, si mësojnë të bashkëjetojnë me të tjerët dhe si përjetojnë jetën e përditshme, duke i dhënë secilit komunitet veçoritë dhe vlerat e veta.

Ndërveprimi mes komunitetit urban dhe rural

Edhe pse janë të ndryshme, komuniteti urban dhe ai rural lidhen ngushtë me njëri - tjetrin. Qyteti ka nevojë për produktet bujqësore që vijnë nga fshati, ndërsa fshati përfiton nga shërbimet, tregu dhe institucionet që ndodhen në qytet.

Sot, shumë familje zgjedhin të jetojnë në fshat por të punojnë në qytet, duke përfituar nga qetësia e jetës rurale dhe mundësitë që ofron qyteti.

Kjo tregon se këto dy komunitete nuk mund të zhvillohen të ndara nga njëri - tjetri.



Pyetje për diskutim

1. Çfarë elementesh e karakterizojnë jetën në qytet? Po të një fshati?
2. Pse komuniteti urban dhe ai rural kanë nevojë për njëri - tjetrin?
3. Pse mendoni se shumë familje nga qyteti zgjedhin të jetojnë në fshat?
Përshkruaj lidhjen e ngushtë që ka qyteti me fshatin në aspektin ekonomik.
A mendon se këto komunitete mund të zhvillohen të ndarë?
Jepni shembuj.
4. Veprimtari në klasë.
Nxënësit ndahen në dy grupe. Secili prej tyre përgatit një poster në të cilin rendit:
 - Grupi 1: Përparësitë e jetës urbane.
 - Grupi 2: Përparësitë e jetës rurale.
 Secili grup prezanton idetë e posterit dhe diskuton me klasën.

Çfarë kuptojmë me ndryshime sasiore dhe cilësore?

Komunitetet nuk janë të pandryshueshme. Ato zhvillohen dhe transformohen vazhdimisht, si në numër ashtu edhe në mënyrën e jetesës. Këto ndryshime ndahen në ndryshime sasiore dhe ndryshime cilësore.

Ndryshimet **sasiore** tregojnë rritje ose pakësim në numër, si rritja e popullsisë, e ndërtimeve, e vendeve të punës ose e të ardhurave.

Ndryshimet **cilësore** lidhen me cilësinë e jetës, mënyrën e organizimit të komunitetit, marrëdhëniet shoqërore dhe vlerat që ndajnë njerëzit.



Ndryshimet cilësore në komunitet

Ndryshimet në stilin e jetesës

Stili i jetesës ka ndryshuar nga mënyra tradicionale në atë moderne. Njerëzit sot i kushtojnë rëndësi kohës së lirë, shoqërisë dhe pushimeve.

Përdorimi i teknologjisë, si interneti, telefonat inteligjentë dhe pagesat online, kanë krijuar kushte më të mira jetese dhe e kanë bërë përditshmërinë më të lehtë. Shumë shërbime që më parë kryheshin fizikisht, sot realizohen online.



Ndryshimet në marrëdhëniet shoqërore

Komunitetet janë bërë më të hapura dhe më tolerante. Organizohen aktivitete humanitare, festa lokale dhe aksione ndihme për njerëzit në nevojë.

Rrjetet sociale kanë ndikuar në forcimin e lidhjeve mes njerëzve dhe në nxitjen e bashkëpunimit dhe vullnetarizmit. Sot është më e lehtë që banorët e një komuniteti të organizohen për një çështje të përbashkët.

Ndryshimet në arsim dhe kulturë

Arsimimi gjatë gjithë jetës ka rritur nivelin e njohurive dhe numrin e profesionistëve. Shtimi i qendrave kulturore dhe aktiviteteve artistike, ka ndryshuar botëkuptimin e njerëzve dhe ka promovuar vlera të rëndësishme, si: respekti, barazia dhe diversiteti. Kultura është bërë më e hapur ndaj ideve të reja dhe ndikimeve bashkëkohore.



Ndryshimet sasiore në komunitet

Rritja e popullsisë dhe urbanizimi

Popullsia e Tiranës është rritur ndjeshëm dhe sot kalon shifrën e 800 000 banorëve. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e migrimit të brendshëm nga rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Shpërndarja e popullsisë lidhet me mundësitë ekonomike.


Zgjerimi urban dhe ndërtimet

Reforma territoriale solli krijimin e bashkive që përfshijnë, si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Ndërtimet janë shtuar me ritëm të shpejtë, duke përfshirë zona rezidenciale dhe kulla shumëkatëshe. Bashkitë e mëdha angazhohen në përmirësimin e shërbimeve urbane, si: rrugët, uji, energjia, arsimi dhe shëndetësia, për t'iu përgjigjur rritjes së popullsisë.

Punësimi dhe ekonomia

Zhvillimi ekonomik ka sjellë hapjen e bizneseve të reja dhe rritjen e vendeve të punës. Sektori i shërbimeve ka numrin më të madh të të punësuarve, duke ndikuar drejtpërdrejt në strukturën ekonomike të komunitetit urban.

Lidhja mes ndryshimeve sasiore dhe cilësore



Shpesh, ndryshimet sasiore sjellin edhe ndryshime cilësore.

Rritja e popullsisë dhe ndërtimeve kërkon më shumë shërbime, por ndryshon edhe mënyrën se si njerëzit bashkëjetojnë, komunikojnë dhe ndajnë hapësirat e përbashkëta.

Kjo tregon se ndryshimet në komunitet ndikojnë jo vetëm në pamje, por ndryshojnë në cilësinë e jetës sociale dhe kulturore.



1. Merrni pranë një orë ose pajisje digjitale dhe matni kohën që ju duhet për të shkruar në fletore një shkrim të shkurtër (rreth 10-15 fjali) mbi ndërtimet e reja në komunitetin tuaj. Regjistroni në fletore kohëzgjatjen e procesit.
2. Shkruani me kompjuter krijimin tuaj duke përdorur programin Word. Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroheni atë në fletore.
3. A mund ta përktheni krijimin tuaj në gjuhë të huaj? Në cilën gjuhë? Si do të vepronit?



Pyetje për diskutim

1. Si ndahen ndryshimet brenda komunitetit?
2. Krahaso ndryshimet sasiore me ato cilësore.
3. Vlerëso ndryshimet më të mëdha që kanë ndodhur në Tiranë.
4. Evidento ngjashmëritë mes Tiranës së djeshme dhe asaj të sotme.
5. Përshtuaj ndryshimet që të kanë ndodhur gjatë periudhës shkollore.

Gjatë këtij projekti ju do të punoni në grupe dhe do të:

- njiheni me rreziqet që lidhen me përdorimin e teknologjisë.
- zbuloni përfitimet që teknologjia sjell në jetën e përditshme.
- mendoni për sfidat që teknologjia sjell në një botë që ndryshon shpejt.
- mësoni të kërkonti, përpunoni dhe prezantoni informacion.

Lexim

Çdo ditë ju përdorni teknologjinë, ndonjëherë edhe pa e kuptuar. Zgjoheni në mëngjes dhe kontrolloni orën në telefon, përdorni internetin për të kërkuar informacion për detyrat, flisni me shokët përmes mesazheve ose luani lojëra online për t'u argëtuar.

Teknologjia ju **ndihmon**. Për shembull, kur përdorni një video mësimore për të kuptuar më mirë mësimin, ose kur dërgoni një punim shkollor me e-mail, kurseni kohë dhe mësoni në mënyrë moderne. Falë teknologjisë, ju mund të zhvilloni aftësi të reja, si: kërkimi i informacionit, krijimi i prezantimeve ose përdorimi i aplikacioneve të ndryshme.

Por teknologjia ka **rreziqe**, sidomos kur nuk përdoret me kujdes. Qëndrimi i gjatë para ekranit shkakton lodhje, mungesë përqendrimi dhe më pak kohë për lojëra në natyrë.



Nuk duhet të jepni të dhëna personale, si: emri, adresa ose fotot private, sepse ka rrezik të keqpërdoren. Nuk duhet të komunikoni me të panjohur në internet, nuk duhet të besoni në çdo lajm që del aty. Kërkoni ndihmën e prindërve dhe mësuesve. Përdorni fjalëkalime të sigurt. Ka shumë rëndësi **sjellja jonë me teknologjinë**.

Të respektojmë të tjerët online, të përdorim gjuhë të sjellshme, të mos përhapim mesazhe fyese dhe të sinjalojmë për sjellje të papërshtatshme.

Ky projekt ju ndihmon të kuptoni se si **teknologjia mund të jetë ndihmës i mirë**, por edhe **mund të kthehet në problem**, nëse nuk përdoret drejt.

Projekti do zhvillohet me etapa

Ju do të punoni në grupe për të realizuar detyrat. Burime informacioni: :

- materiale nga interneti,
- libra dhe revista,
- faqe informative ndërkombëtare (OECD, UNESCO),
- shembuj nga jeta e përditshme.

Secili grup do të përgatisë një prezantim Power Point, ku do të paraqesë punën e vet para klasës.

Ora e parë e projektit: Ndarja në grupe dhe përzgjedhja e temës.

Në këtë orë ju do të njiheni me mënyrën se si do të organizohet puna dhe çfarë pritet nga secili grup. Diskutoni idetë tuaja: si e përdorni dhe çfarë mendoni për teknologjinë.

Klasa ndahet në grupe pune. Çdo grup zgjedh një drejtues grupi, i cili ndihmon në organizimin e punës. Detyrat ndahen mes anëtarëve të grupit në mënyrë të barabartë.

Tematikat e grupeve:

Grupi 1 – Përdorimi i teknologjisë

- pajisjet teknologjike që përdorni,
- përdorimin e teknologjisë në shkollë dhe në shtëpi,
- raste nga jeta e përditshme,
- ilustrime ose foto,
- përfundime (çfarë mësuat).

Shembull: Një nxënës përdor tabletin ose kompjuterin për të ndjekur një video mësimore, për të bërë detyrat ose për të dërguar një punim me e-mail mësuesit. Në shtëpi, familja përdor telefonin për të komunikuar me të afërmit që jetojnë larg.

Grupi 3 – Përfitimet nga teknologjia

- mësimin me mjete bashkëkohore,
- mundësitë ekonomike,
- zhvillimin e aftësive digjitale,
- argëtimin dhe krijimtarinë,
- foto dhe përfundime.

Shembull: Nxënësit përdorin internetin për të kërkuar informacion për një projekt shkollor ose për të mësuar një aftësi të re, si vizatimi digjital ose programimi bazë. Teknologjia u jep mundësi të mësojnë gjëra që më parë ishin të vështira për t'u arritur.

Grupi 5 – Siguria në internet

- mbrojtja e të dhënave personale,
- mosndarja e informacionit privat,
- krijimi i fjalëkalimeve të sigurta,
- foto dhe përfundime.

Shembull: Nxënësi nuk ndan fjalëkalimin e llogarisë së tij, nuk jep në internet adresën, numrin e telefonit apo foto personale, mbron fjalëkalimin dhe llogarinë personale.

Si do ta realizoni projektin: Hapat e punës

Hapi 1 – Njihuni me temën. Lexoni me kujdes temën: “Rreziqet dhe përfitimet e teknologjisë” dhe diskutoni në klasë:

- Çfarë pajisjesh teknologjike përdorni çdo ditë?
- Për çfarë ju ndihmon teknologjia?
- A keni dëgjuar ndonjëherë për rreziqe në internet?

Qëllimi i këtij hapi është që secili prej jush të shprehë mendimin e vet dhe të kuptojë pse kjo temë është e rëndësishme për jetën tuaj të përditshme.

Grupi 2 – Rreziqet nga teknologjia

- varësia nga teknologjia,
- izolimi social,
- komunikimi me persona të panjohur,
- dezinformimi në internet,
- foto dhe përfundime.

Shembull: Një fëmijë po kalon shumë orë duke luajtur lojëra online dhe fillon të mos dalë më për të luajtur me shokët. Ai ndihet i lodhur. Në një rast tjetër, një nxënës merr mesazhe nga një person i panjohur në rrjetet sociale, gjë që mund të jetë e rrezikshme nëse nuk tregohet kujdes.

Grupi 4 – Sjellja qytetare në teknologji

- respektimi i të tjerëve online,
- gjuha e përdorur në internet,
- raportimi i sjelljeve negative,
- foto dhe përfundime.

Shembull: Gjatë një bisede në një grup online të klasës, një nxënës flet sjellshëm, respekton mendimin e shokëve. Kur shih një koment fytes ose bullizëm, ai sinjalizon dhe nuk merr pjesë në përhapjen e tij.



Hapi 2 – Formoni grupet e punës. Klasa ndahet në grupe pune.

Në secilin grup:

- zgjidhni një drejtues grupi.
- ndani detyrat mes anëtarëve (kërkim, shkrim, përzgjedhje fotosh, prezantim).

Të gjithë duhet të kenë një rol dhe të kontribuojnë.

Hapi 3 – Hulumtoni dhe mblidhni informacion

Secili grup punon mbi temën e vet në këtë formë:

- kërkon informacion në libra, materiale shkollore ose faqe të sigurt në internet;
- përdor shembuj nga jeta e përditshme (shkollë, familje, rrjete sociale);
- zgjedh disa foto ose ilustrime që lidhen me temën tuaj.

Mos kopjoni thjesht tekstin, por përpikuni ta kuptoni dhe ta shpjegoni me fjalët tuaja.

Hapi 4 – Organizoni idetë

Pasi të keni mbledhur informacionin, renditni idetë kryesore; ndani përmbajtjen në pjesë të qarta (p.sh.: çfarë është, pse ndodh, si ndikon te ne); përgatitni përfundime:

çfarë mësuat dhe çfarë mesazhi doni t'u jepni shokëve.

Ky hap ju ndihmon të mendoni në mënyrë kritike.

Hapi 5 – Përgatitni prezantimin

Përgatitni një prezantim PowerPoint:

- përdorni pak tekst dhe fjali të thjeshta;
- shtoni foto që shpjegojnë idetë;
- sigurohuni që çdo slide të ketë një mesazh të qartë.

Prezantimi duhet të jetë i kuptueshëm për gjithë klasën.

Hapi 6 – Prezantoni punën tuaj (ora 3)

Çdo grup prezanton punën para klasës:


- flisni me radhë;
- shpjegoni idetë kryesore;
- dëgjoni me respekt grupet e tjera.

Pas prezantimeve, bëhen pyetje dhe diskutime në fund, me pyetje - përgjigje.

Hapi 7 – Reflektoni mbi atë që mësuat

Në fund të projektit, mendoni:

- Çfarë mësuat për teknologjinë?
- Cili rrezik ju duk më i rëndësishëm?
- Si do të silleni më ndryshe në përdorimin e teknologjisë?



Fjalor


Bullizëm - quhet sjellja e përsëritur e dhunshme ose fyese ndaj një personi tjetër, me qëllim ta lëndojë, ta frikësojë ose ta poshtërojë. Bullizmi mund të ndodhë në shkollë, në lagje ose në internet dhe të jetë i formave të ndryshme.

Në çdo komunitet ekzistojnë institucione që kanë për detyrë të ndihmojnë qytetarët dhe të përmirësojnë jetën e përditshme. Këto institucione janë pranë njerëzve për nevojat e tyre sociale, ekonomike dhe shëndetësore.

Ato luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e qytetarëve dhe në krijimin e barazisë sociale. Bashkia është institucioni kryesor i pushtetit vendor. Ajo kujdeset për jetën e përditshme të qytetarëve në qytet dhe në fshat dhe quhet shpesh "qeveria lokale".

Bashkia ofron shërbime që lidhen me strehimin, ndihmën ekonomike, pastrimin, arsimin, shëndetin. Kryetari i bashkisë zgjidhet me votë nga qytetarët për një mandat 4-vjeçar. Ai drejton bashkinë, kujdeset për buxhetin, për zgjidhjen e problemeve të komunitetit dhe për menaxhimin e emergjencave lokale. Kryetari përfaqëson qytetin dhe zbaton vendimet e këshillit bashkiak.

Ky këshill merr vendime të rëndësishme për komunitetin, miraton buxhetin, planet zhvillimore dhe rregulloret lokale, si dhe kontrollon punën e kryetarit të bashkisë.



Bashkia Tiranë

Pse ekzistojnë institucionet pranë komunitetit

Institucionet pranë komunitetit nuk janë thjesht zyra apo ndërtesa ku punojnë disa njerëz. Ato ekzistojnë sepse në çdo shoqëri ka persona dhe familje që, në çaste të caktuara, **nuk mund t'ia dalin vetëm**. Sëmundja, aksidenti, papunësia apo varfëria mund ta bëjnë jetën shumë të vështirë, edhe për familje që më parë jetonin normalisht.

Në këto raste, institucionet janë ura që lidhin qytetarin me ndihmën, sigurinë dhe dinjitetin.

Pa ato, shumë njerëz do të mbeteshin të pambrojtur dhe të përjashtuar nga jeta normale e komunitetit.

Kjo është arsyeja pse institucionet pranë komunitetit kanë *rol social*, jo vetëm administrativ.

Bashkia: më shumë se një administratë

Bashkia është institucioni që sheh nga afër problemet e komunitetit. Ajo nuk merret vetëm me shërbime të dukshme si: rrugët apo parqet, por edhe me problemet sociale që nuk shihen lehtë, si: varfëria, strehimi apo përjashtimi social. Kur bashkia ofron banesa sociale ose ndihmë ekonomike, ajo nuk po "dhuron", por po përmbush një detyrë publike: të sigurojë që qytetarët të kenë jetë normale. Pra bashkia mbështet barazinë sociale.

Kryetari i bashkisë: përgjegjësi, jo vetëm pushtet

Kryetari i bashkisë nuk është thjesht drejtues formal. Ai mban përgjegjësi për mënyrën se si përdoret buxheti publik dhe për mënyrën se si trajtohen nevojat e qytetarëve. Vendimet që merr ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme: a do të ketë ndihmë për familjet në nevojë, a do të ndërtohen banesa sociale, a do të përmirësohen shërbimet. Në rast

emergjencash lokale, si përmbajtje apo tërmete, roli i kryetarit të bashkisë bëhet jetik, sepse ai koordinon ndihmën dhe siguron mbrojtjen e qytetarëve.

Këshilli bashkiak – zëri i qytetarëve në vendimmarrje

Këshilli i bashkisë është institucioni që përfaqëson qytetarët në vendime. Ai vendos se ku do të shkojnë paratë e bashkisë, çfarë shërbimesh do të kenë përparësi.

Prania e tij siguron kontroll, transparencë dhe mbrojtje të interesit publik.

Institucionet pranë komunitetit në vendet e tjera

Në Suedi, bashkitë ofrojnë strehim social dhe ndihmë financiare për familjet që përballen me papunësi, sëmundje ose paaftësi fizike.

Familjet me persona me aftësi të kufizuara përfitojnë banesa të përshtatura dhe shërbime sociale, në mënyrë që të jetojnë me dinjitet.

Në Itali, bashkitë dhe qendrat sociale ndihmojnë familjet në nevojë duke ofruar ushqime, veshje dhe ndihmë ekonomike. Në disa qytete organizohen edhe mensa sociale ku familjet ose të moshuarit mund të marrin ushqim falas.

Në Kanada, pushteti vendor bashkëpunon me organizata sociale për të mbështetur familjet me të ardhura të ulëta. Ofrohen programe strehimi, ndihmë për pagesën e qirasë dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që askush të mos mbetet pa ndihmë. Përveç ndihmës ekonomike, ofrohen shërbime këshillimi dhe mbështetje për fëmijët, në mënyrë që varfëria të mos trashëgohet brez pas brezi.

Në Gjermani, bashkitë ofrojnë strehim social dhe ndihmë financiare për familjet që humbasin punën ose kanë anëtarë me aftësi të kufizuara.

Qëllimi nuk është vetëm mbijetesë, por integrimi i plotë në shoqëri.

Këta shembuj tregojnë se institucionet pranë komunitetit janë të rëndësishme jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera të botës.

Institucionet pranë komunitetit ndihmojnë qytetarët në momente të vështira dhe krijojnë kushte për një jetë më të drejtë dhe më të sigurt.

Ato ndihmojnë në uljen e varfërisë, mbrojtjen e familjeve në nevojë dhe përmirësimin e jetës sociale. E drejta për një jetesë dinjitoze mbrohet dhe nga Kushtetuta e vendit tonë.



Pyetje për diskutim

1. Rendit institucionet e qeverisjes vendore.
2. Përshkruaj rolin e bashkisë, kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak.
3. Vlerëso rëndësinë e këtyre institucioneve për familjet në nevojë.
4. A keni marrë pjesë ndonjëherë në aktivitete të organizuara nga bashkia?
5. Harto një letër drejtuar kryetarit të bashkisë ku jeton. Shkruaj çfarë mendon se duhet përmirësuar në punën e bashkisë për të ndihmuar më mirë komunitetin.



Fjalor

Administratë - grupi i njerëzve dhe strukturave që organizojnë, zbatojnë dhe kontrollojnë vendimet e shtetit ose të bashkisë, në mënyrë që jeta e qytetarëve të funksionojë normalisht.

Çfarë është reagimi qytetar

Reagimi qytetar është mënyra se si qytetarët shprehin mendimin e tyre dhe veprojnë kur shohin probleme, padrejtësi ose nevoja në komunitetin ku jetojnë.

Ky reagim është i ligjshëm dhe tregon se qytetarët nuk janë indiferentë, por ndihen përgjegjës për mirëqenien e përbashkët dhe për përmirësimin e jetës në komunitet.

Reagimi qytetar nuk është as konflikt apo dhunë. Ai duhet të jetë i përgjegjshëm, paqësor, sepse synon zgjidhjen e problemeve dhe jo përkeqësimin e tyre. Kur qytetarët aktivizohen, komuniteti bëhet më i fortë dhe institucionet më përgjegjëse.

Shembulli i shkëlqyer i reagimit qytetar është Greta Thunberg. Në moshën 15 vjeç, viti 2018, ajo filloi të protestonte para Parlamentit Suedez, për ndryshimet klimatike. Kështu filloi një lëvizje e madhe rinore, që frymëzoi miliona njerëz në botë.



Greta Thunberg



Reagimi qytetar për mbrojtjen e mjedisit, problem global



1. Krijoni skica të thjeshta në fletoren e vizatimit mbi reagimet paqësore që keni parë.
2. Vizatoni me kompjuter krijimet tuaja duke përdorur programin Paint.
Sa ishte kohëzgjatja e këtij procesi? Regjistroni atë në fletore.
3. Me ndihmën e mësuesit/es, printoni një poster artistik me krijimet digjitale.

Pse është i rëndësishëm reagimi qytetar

Nëse qytetarët nuk reagojnë, problemet në komunitet rriten dhe padrejtësitë mbeten pa zgjidhje. Heshtja dhe indiferenca dobësojnë demokracinë dhe e bëjnë komunitetin më të pambrojtur. Përkundrazi, reagimi qytetar ndihmon në përmirësimin e shërbimeve, rrit përgjegjësinë e institucioneve dhe forcon bashkëpunimin mes njerëzve.

Reagimi qytetar i mëson njerëzit të respektojnë rregullat, të bashkëpunojnë dhe të kërkojnë zgjidhje pa dhunë, duke ndërtuar një shoqëri më të drejtë.

Forma të reagimit qytetar

Reagimi pozitiv. Reagimi pozitiv ndodh kur qytetarët veprojnë në mënyrë paqësore dhe konstruktive. Forma të tilla janë: dialogu me institucionet, nënshkrimi i peticioneve, vullnetarizmi dhe pjesëmarrja në aktivitete komunitare. Për shembull, banorët e një lagjeje mund



të nënshkruajnë një kërkesë për ndërtimin e një fushe sportive ose të organizojnë një aksion pastrimi.

Reagimi të ndryshme

Reagimi negativ përfshin: dhunën, shkatërrimin e pronës, fyerjet dhe urrejtjen. Këto forma nuk sjellin zgjidhje, nuk janë të ligjshme dhe përkeqësojnë më shumë problemet. Një reagim i tillë dëmton komunitetin dhe cenon sigurinë e qytetarëve.

Shembuj reagimesh pozitive:

- Në një lagje mungon ndriçimi i rrugëve. Banorët i drejtohen bashkisë me kërkesë zyrtare dhe ndriçimi rregullohet.
Ky është reagim qytetar pozitiv.
- Nxënësit vërejnë se oborri i shkollës është i ndotur dhe organizojnë një aksion pastrimi, ku u mbështetën nga mësuesit.
- Banorët ankohen për zhurmën e lartë të lokaleve në mbrëmje dhe kërkojnë ndërhyrjen e bashkisë për respektimin e rregullave.
Bashkia u vendosi orar lokaleve.



Reagimi qytetar dhe institucionet

Veprimet qytetare lidhen ngushtë me institucionet. Kur qytetarët reagojnë në mënyrë të organizuar të ligjshme dhe paqësore, institucionet janë të detyruara të dëgjojnë dhe të veprojnë për përmirësimin e situatës. Kjo marrëdhënie ndihmon në ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe në përmirësimin e shërbimeve për publikun.




Pyetje për diskutim

1. Çfarë kupton me reagim qytetar?
2. Cilat janë format pozitive të reagimit qytetar?
3. Pse reagimi qytetar duhet të jetë paqësor?
4. Jep një shembull reagimi qytetar në komunitetin tënd. Mendo për një problem në komunitetin ku jeton. Shkruaj si do të reagoje ti si qytetar i përgjegjshëm për ta përmirësuar situatën.
5. Veprimtari klase: Ndahuni në 3 grupe. Çdo grup merr një situatë konkrete, si:
 - mungesa e një fushe sportive në lagje,
 - zhurma e lartë në lokalet përreth,
 - mosfunksionimi i një shërbimi publik

Diskutoni se si duhet të reagojë një qytetar i përgjegjshëm dhe propozoni një zgjidhje paqësore.

2.10 KORRUPSIONI

Korrupsioni është sjellje e padrejtë, ku dikush përdor pushtetin ose detyrën e tij për të marrë përfitime për vete ose për një tjetër. Korrupsioni mund të jetë: marrje parash, dhurata,



favore, ose marrja e një vendimi të gabuar me qëllim përfitimi. Ai ndodh kur njerëzit nuk sillen me ndershmëri dhe nuk i respektojnë rregullat e shoqërisë, që mbrojnë të mirën e përbashkët.

Korrupsioni nuk ndodh vetëm në vende të mëdha, institucione shtetërore apo kompani.

Ai mund të shfaqet edhe brenda komunitetit tonë. Për shembull, kur një person në pushtet favorizon vetëm të njohurit e tij, apo kur dikush jep dhurata që të marrë një trajtim të veçantë.

Çdo veprim i tillë dëmton drejtësinë dhe besimin

mes njerëzve. Një shoqëri ku ka korrupsion nuk funksionon mirë, sepse njerëzit ndihen të pafuqishëm dhe mendojnë se gjërat nuk zgjidhen me meritë, por me favore.

Korrupsioni si vënie e interesit vetjak mbi të mirën e përbashkët

Në çdo komunitet, punonjësit e shtetit kanë detyrën t'u shërbejnë qytetarëve në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Ata duhet të zbatojnë ligjin dhe të kujdesen që shërbimet publike të funksionojnë për të gjithë. Ka raste kur disa persona me poste publike nuk tregohen të ndershëm. Në vend që të punojnë për komunitetin, ata përdorin detyrën e tyre për përfitime personale. Ndodh që vonojnë qëllimisht shërbimet për të detyruar qytetarët që t'i paguajnë. Korrupsioni është një nga armiqtë kryesorë të së mirës së përbashkët.

Kur dikush që ka përgjegjësi publike zgjedh interesin vetjak në vend të interesit të komunitetit, atëherë priset besimi mes qytetarëve dhe institucioneve. Në vend që puna



komunitare të jetë për të gjithë, ajo përdoret vetëm për përfitime të një personi apo grupi. Kjo dobëson shoqërinë dhe e pengon atë të zhvillohet. Shembujt e korrupsionit shihen kudo në botë. Edhe në Europë janë zbuluar raste kur politikanë kanë përdorur fondet publike.

Korrupsioni nuk është problem vetëm i një vendi të caktuar, por një pengesë që dëmton të mirën e përbashkët kudo ku ai shfaqet.

Prandaj qeveria dhe institucionet duhet të rrisin kontrollin ndaj pushtetarëve.

Skaqet e korrupsionit

Në shoqëri ekzistojnë disa arsye që e nxisin korrupsionin si:

1. **Pamjaftueshmëria e të ardhurave.** Disa punonjës publikë tundohen të marrin rryshfet për të shtuar të ardhurat e tyre të ulëta.
2. **Tradita shoqërore.** Në disa raste, njerëzit mendojnë se dhënia e një "statusi" apo "ndihme të vogël" është mënyrë normale për të zgjidhur punët. Kjo e bën korrupsionin të duket si praktikë e zakonshme.

3. *Mungesa e shtetit ligjor*. Kur institucionet nuk kontrollojnë si duhet dhe nuk tregojnë transparencë, krijohen hapësira që lejojnë sjellje abuzive.
4. *Vakumi ligjor*. Ligje të paqarta, të paplota ose të shkruara keq lejojnë korrupsionin të futet në çdo hallkë të shoqërisë.
5. *Mosfunksionimi i gjykatave*. Nëse drejtësia nuk ndëshkon shkelësit e ligjit, atëherë njerëzit humbasin besimin se merita dhe ndershmëria vlerësohen.

Shembuj nga jeta e përditshme

- Legalizimi i ndërtimeve pa leje që nuk përputhen me ligjin.
- Favorizimi i një personi vetëm sepse “ka njohje”.
- Marrja e një shërbimi më shpejt sepse dikush ka paguar padrejtësisht.
- Vendime të padrejta në shkollë, sport apo komunitet që nuk bazohen në meritë.

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) është një nga matjet më të përdorura në botë për të kuptuar sa i korruptuar perceptohet një vend.

Ai publikohet çdo vit nga organizata ndërkombëtare Transparency International, e cila analizon 180 shtete dhe territore duke u bazuar në të dhënat e mbledhura nga ekspertë, studime, institucione ndërkombëtare dhe sondazhe të sektorit të biznesit.

CPI përdor një shkallë nga 0 deri në 100, ku:

0 pikë= vendi perceptohet si shumë i korruptuar

100 pikë= vendi perceptohet si shumë i pastër, me institucione të forta dhe sundim të ligjit

Në raportin CPI 2024, Transparency International sqaron qartë se shumica e vendeve në botë (më shumë se 2/3) marrin më pak se 50 pikë, që do të thotë se korrupsioni është problem i përhapur në shumë shtete.



Pyetje për diskutim

1. Çfarë është korrupsioni?
2. Cilat janë shkaqet kryesore të tij?
3. Jep një rast të korrupsionit që ke parë ose dëgjuar në jetën e përditshme. A e pengon korrupsioni zhvillimin e një vendi? Si?
4. Diskutim në klasë:
Ndahuni në grupe dhe secili grup përshkruan si e ka kuptuar ai keqpërdorimin e pushtetit në Shqipëri.
Jepni mendimin tuaj se si mund të përmirësohet gjendja.



Korrupsioni ndikon në shumë aspekte të jetës. Ai dëmton cilësinë e shërbimeve, ul nivelin e drejtësisë, rrit pasiguritë dhe krijon pabarazi të mëdha.

Në një qytet me korrupsion, mund të ndërtohen rrugë të bukura dhe lulishte, por ato prishen shpejt, sepse punimet janë kryer jo cilësisht.

Në spital, njerëzit mund të presin më gjatë për shërbime, sepse, disa paguajnë dhe shërbehen më shpejt. Në institucione, mund të ndodhë që dokumentet mund të vonohen nëse punonjësit presin që t'i paguash.

Edhe në shkollë, korrupsioni mund të shfaqet në forma, si kur një nxënës përpigjet të marrë notë pa meritë, kur dikush kopjon ose kur dikush mundohet të fitojë favore që nuk i takojnë.

Këto veprime dëmtojnë ata që punojnë me ndershmëri. Prandaj, qeveria ka filluar luftën ndaj korrupsionit, në çdo sektor.

Pasojat kryesore të korrupsionit

Dobësimi i besimit të shteti. Korrupsioni e bën qytetarin të ndihet i pambrojtur.

Ai mendon se rregullat nuk vlejnë për të gjithë, por vetëm për ata që kanë lidhje me pushtetin.

Kur besimi tek institucionet ulet, bie dëshira e njerëzve për të kontribuar, për të paguar taksa.

Rritja e pabarazisë.

Korrupsioni nënkupton që paratë e publikut, nuk përdoren për qytetarët. Zvogëlohen investimet në: shkolla, spitale, rrugë dhe shërbime të tjera.

Rritja e emigracionit.

Kur qytetarët e humbin shpresën për një të ardhme më të mirë në vendin e tyre, ata largohen. Të rinjtë kërkojnë mundësi në shtete të tjera, gjë që sjell largimin e intelektualëve dhe forcës së punës. Qeveria nxit intelektualët dhe studentët e diplomuar jashtë vendit, që të kthehen, të kontribuojnë për vendin.

Ulja e investimeve të huaja.

Kompanitë serioze nuk investojnë në një vend ku mund të merren vendime të padrejta. Kjo do të thotë më pak vende pune, më pak zhvillim ekonomik dhe më pak të ardhura për shtetin, më pak ndihma nga Bashkimi Europian dhe shtetet e tjera me të cilat kemi marrënie ekonomike.

Lufta kundër korrupsionit duhet të jetë e vazhdueshme, me qëllim që vendi ynë të afrohet sa më shpejt me standardet e Bashkimit Europian.



Si luftohet korrupsioni?

Lufta kundër korrupsionit është proces i gjatë, që përfshin qytetarët, shkollat, institucionet dhe qeverinë. Ajo bazohet në tri drejtime kryesore:

1. Parandalimi - Të ndalohet korrupsioni para se të ndodhë.
 - Institucionet të jenë transparente dhe të hapura për publikun.
 - Shërbimet të ofrohen online (shumë shërbime sot bëhen online).
 - Punonjësit e shtetit të trajnohen, të jenë të sjellshëm e të duan vendin.
2. Ndëshkimi - Korrupsioni duhet të hetohet dhe të dënohet, që të mos përsëritet.
 - Forcimi i institucioneve të drejtësisë.
 - Rritja e bashkëpunimit me vendet e tjera.
3. Ndërgjegjësimi - Qytetarët duhet të kuptojnë se korrupsioni dëmton të gjithë.
 - Edukim antikorrupsion që në shkollë.
 - Fushata informuese për qytetarët.
 - Nxitje e raportimit të rasteve të dyshuara.



Kërkoni në internet podcast-e apo video me të dhëna zyrtare e shkencore mbi aktivitetet sociale mbi korrupsionin në tri qytete të Shqipërisë. Bëni një përmbledhje me faktet më të veçanta që mësuat. Mos harroni që të citoni burimin e informacionit.

Këto masa janë pjesë e: “Strategjisë Kundër Korrupsionit, 2024 – 2030”, planit kombëtar që synon forcimin e integritetit dhe drejtësisë, të cilat duhet të përmirësojnë gjendjen, drejt një shteti modern, të përparuar e të sigurt, ku të shihet e ardhme më e mirë.

Edukimi për integritet moral

Integriteti moral do të thotë të veprosh siç duhet, ndershmërisht, edhe kur askush nuk të shikon. Në shkollë, kjo edukohet përmes punës cilësore, moskopjimit, lojës së drejtë dhe respektimit të rregullave, sjelljes qytetare.

Mësuesit dhe prindërit kanë rol të rëndësishëm për të ndihmuar fëmijët, që të kuptojnë se zgjidhjet e padrejta të një problemi, nuk sjellin sukses të vërtetë. Nxënësit duhet të mësojnë, të përgatiten për të qenë qytetarë të ndershmë e të përgjegjshëm të vendit tonë.



Pyetje për diskutim

1. Cilat janë pasojat më të rëndësishme të korrupsionit?
2. A ekziston korrupsion edhe në vende të zhvilluara?
3. Si ndikon largimi i të rinjve nga vendi të e ardhmja e Shqipërisë?

Detyrë. Pse të rinjtë e diplomuar jashtë shtetit, duhet të kthehen përsëri në vendin tonë? Shkruani në fletore për këtë temë.



3. Tregu global



Rezultatet e të nxënit

- lidh biznesin, klientin, kulturën, tregtinë, specializimin, barrierat tregtare, monedhën dhe fuqinë punëtore globale;
- zbaton njohuritë e marra në një projekt të thjeshtë në grup;
- analizon situata të ndryshme ekonomike dhe jep mendim të argumentuar.

Fjalë kyçe

biznes, klient, kulturë, tregti, import, eksport, specializim, ndërvarësi, barrierë tregtare, monedhë, kurs këmbimi, fuqi punëtore globale.



Rezultatet e të nxënit:

- dallon biznesin nga klienti;
- identifikon produkte dhe shërbime në situata reale;
- përshkruan marrëdhënien biznes–klient në treg;
- analizon situata të thjeshta të etikës në biznes.

Biznes, klient, produkt, shërbim, treg, fitim, nevojë, dëshirë, etikë, dilemë etike.

Ti shkon në një dyqan për të blerë një palë atlete.



- A i bleve atletet sepse nuk kishe asnjë palë tjetër, apo sepse dëshiroje një model më të ri e më të bukur?
- Kush t'i shiti?
- Pse zgjodhe ato dhe jo të tjera?
- Çfarë përfiton ti si klient?
- Çfarë përfiton biznesi?

Biznesi dhe klienti

Biznesi është një veprimtari (kompani) që shet produkte ose shërbime për të krijuar fitim. Klienti është ai që blen produkte ose shërbime.

Biznes



ofron



Produkt/Shërbim



Klient



paguan



Biznesin & klienti jep mendimin për shërbimin

Marrëdhënia biznes–klient:

- Biznesi ofron.
- Klienti paguan.
- Të dyja palët përfitojnë.



- A mund të ekzistojë biznesi pa klientë?

Produkte dhe shërbime

Produkt është një mall fizik ose online, që prodhohet dhe mund të blihet nga klientët, p.sh. ushqime, telefon, roba etj. Shërbim është një aktivitet fizik ose online, që kryhet për të plotësuar një nevojë të klientit, p.sh. transporti, prerja e flokëve, riparimi i makinës, kurs online etj. Bizneset mund të ofrojnë produkte, shërbime ose të dyja.



- Cilat produkte dhe shërbime përdor ti çdo ditë?




Tregu

Tregu është vendi dhe sistemi, ku bizneset dhe klientët takohen për të shkëmbyer produkte dhe shërbime. Tregu mund të jetë fizik (supermarket, treg etj.) ose online (dyqane në internet). Tregu është i rëndësishëm sepse lidh bizneset me klientët dhe krijon mundësi për shitje dhe blerje.



- Pse disa njerëz preferojnë të blejnë online dhe të tjerë në dyqan?





Nevojat dhe dëshirat

➤ Nevojat janë të domosdoshme. ➤ Dëshirat janë çfarë ne dëshirojmë.
Bizneset përpiqen t'i plotësojnë të dyja



➤ A ndryshojnë zgjedhjet e tua kur ke më pak para?

Fitimi

Fitimi është paraja, që mbetet pasi biznesi ka paguar të gjitha shpenzimet si: mallrat, dritat, taksat, rrogat e punonjësve etj. Qëllimi i biznesit është të ketë fitim dhe të plotësojë nevojat e klientëve.

P.sh. një biznes shet një produkt për 100 lekë dhe shpenzon 70 lekë për ta prodhuar. Fitimi është 30 lekë.



➤ Pse është i rëndësishëm fitimi për biznesin?

Etika në biznes

Etika lidhet me zgjedhjen midis asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar.

Një biznes i përgjegjshëm respekton klientët. Ai kujdeset për punonjësit dhe mbrojtjen e të dhënave të tyre. Biznesi kujdeset edhe për mbrojtjen e mjedisit.



➤ A është gjithmonë fitimi më i rëndësishëm?

Dilema etike

Dilema etike është një situatë, ku duhet të zgjedhësh midis dy vendimeve të vështira, fitimit të parave dhe të qenit i ndershem me klientin. Për shembull të përdorësh materiale më të lira apo të përdorësh materiale më cilësore dhe të sigurta.

Rast studimor - Mobiliat e importuara

Një biznes në Shqipëri shet mobilie të importuara, që janë më të lira se ato të prodhuara në vend. Për pasojë klientët blejnë më lirë, ndërsa bizneset vendase kanë më pak shitje.



- Pse klientët zgjedhin produktet më të lira?
- Si ndikon kjo te prodhuesit vendas?
- A përfitojnë të gjithë njësoj nga kjo situatë? Pse?

1 Në jetën tënde

Shkruaj 2 produkte që ke blerë dhe 2 shërbime që ke përdorur këtë javë.


2 Si funksionon tregu?

Përdor shembuj nga jeta jote.

Biznesi	Produkti/Shërbimi	Klienti

3 Ku blejmë?

Shkruaj 3 vende ku blen zakonisht. Cili është ndryshimi midis dyqanit fizik dhe blerjes online?



4 Ti je sipërmarrës

Vendose veten në rolin e një sipërmarrësi. Mendo:

- › Çfarë do të shesësh?
- › Kujt do t'ia shesësh?
- › Si do të të zgjedhin klientët?

5 Dilemë etike

Në biznesin tënd duhet të zgjedhësh materiale më të lira apo materiale më të sigurta.

Si do të veprosh?
Argumento përgjigjen.

Diskuto

- › A duhet që bizneset të mendojnë vetëm për fitimin?
- › Si ndikon biznesi në jetën tonë të përditshme?
- › Çfarë është një biznes i drejtë?

Mbaj mend!

- › Biznesi shet, klienti blen.
- › Produktet dhe shërbimet plotësojnë nevoja dhe dëshira.
- › Tregu lidh bizneset me klientët.
- › Fitimi është i rëndësishëm.
- › Etika ndihmon në marrjen e vendimeve të drejta.

Reflekto

- › Cili koncept të duket më i rëndësishëm në këtë mësim?
- › Si ndryshojnë zgjedhjet e tua si klient kur mendon për etikën?
- › Si do të veproje ti si biznes për të qenë i drejtë?



Aktivitetet e këtij mësimi mund të zhvillohen edhe duke përdorur platformën digjitale: lms.junior-albania.org/course.



Rezultatet e të nxënës:

- dallon ndikimin e ndryshimeve kulturore në nevojat dhe dëshirat e klientëve;
- krahason elemente të kulturave në vende të ndryshme;
- identifikon situata, ku zakonet dhe kultura ndikojnë në marrëdhëniet me klientët;
- argumenton që njohja e kulturës është e rëndësishme për suksesin e biznesit.

Kulturë, zakone, tradita, preferenca, klient, biznes, etiketa, treg, përshtatje.

Imagjino sikur ke shkuar të vizitosh një shtet tjetër dhe shkon në një restorant.



- > A mendon se ushqimi është i njëjtë si në Shqipëri?
- > A do të zgjedhin njerëzit e tjerë në restorant të njëjtat produkte si ti?
- > Pse njerëzit në vende të ndryshme bëjnë zgjedhje të ndryshme?

Kultura

Kultura është mënyra sesi jetojnë njerëzit në një vend, duke përfshirë, ushqimin, zakonet, traditat dhe mënyrën e jetesës. Kultura ndikon në mënyrën si njerëzit blejnë dhe përdorin produkte.

Klienti dhe kultura

Klientët në vende të ndryshme kanë nevoja, dëshira dhe zgjedhje të ndryshme. Këto ndryshime lidhen me kulturën. Ndryshimet kulturore janë dallimet, që ekzistojnë midis mënyrës së jetesës së njerëzve në vende të ndryshme, si ushqimi, zakonet, traditat dhe sjellja.



- > Jep një shembull, kur njerëzit zgjedhin produkte të ndryshme për shkak të kulturës.



Preferencat e klientëve

Preferencat janë zgjedhjet që bëjnë klientët për produktet dhe shërbimet. Ato varen nga:

- > kultura
- > zakonet
- > mënyra e jetesës.



- > Çfarë ndikon më shumë në zgjedhjet e tua, nevojat apo zakonet?

Përshtatja e biznesit

Bizneset duhet të kuptojnë kulturën e klientëve. Për këtë ato:

- › ndryshojnë produktet;
- › përshtatin shërbimet;
- › ofrojnë produkte që i përshtaten tregut lokal.

Bizneset përshtaten për të plotësuar nevojat e klientëve në kultura të ndryshme.

Shembull

Një kompani ndërkombëtare ushqimesh të shpejta nuk ka të njëjtën menu në çdo vend. Në disa vende ofrohen ushqime lokale ose ndryshohen përbërësit. Pra, ushqimet përshtaten me zakonet dhe besimet. Kjo bëhet për të përmbushur preferencat e klientëve.



- › Çfarë ndodh nëse një biznes nuk përshtatet me kulturën e klientëve?

Etiketa në biznes dhe zakonet kulturore

Etiketa janë rregulla të sjelljes që ndryshojnë nga një kulturë në tjetrën.

Në kultura të ndryshme:

- › mënyra e të veshurit ndryshon;
- › dhuratat kanë kuptime të ndryshme;
- › ngjyrat kanë kuptime të ndryshme.

Në disa vende, një ngjyrë mund të simbolizojë fat, në vende të tjera, e njëjta ngjyrë mund të lidhet me ngjarje të tjera. Bizneset duhet t'i njohin këto dallime për të shmangur gabime. Bizneset që nuk kuptojnë kulturën mund të dështojnë në treg.



- › Çfarë sjelljeje konsiderohet e përshtatshme në Shqipëri?
- › A mendon se është e njëjtë në çdo vend? P.sh. Përhëndetjet në Japoni bëhen përmes përkuljes së trupit, ndërsa në Europë përmes shtrëngimit të duarve.

Rast studimor - Një biznes në një vend tjetër

Një biznes nga Shqipëria hap një restorant në një vend tjetër dhe ofron të njëjtin ushqim si në Shqipëri. Pas një kohe, klientët nuk blejnë shumë sepse ushqimi nuk përputhet me shijet e tyre.



- › Pse klientët nuk e pëlqejnë ushqimin?
- › Si ndikon kultura në këtë situatë?
- › Çfarë duhet të ndryshojë biznesi?
- › A duhet të përshtatet me kulturën lokale?
- › Cili është më i rëndësishëm identiteti i biznesit apo kultura lokale?
- › A duhet biznesi të ndryshojë gjithmonë produktin?

1 Në jetën tënde

Shkruaj:

- › një ushqim tipik shqiptar
- › një ushqim nga një vend tjetër

Ku ndryshojnë këto ushqime?

2 Krahaso kulturat

Plotëso tabelën.

Vendi	Ushqimi	Zakoni
 Shqipëria	Byrek	Gatuhet në familje
 Itali		
 Kina		

- Çfarë ndryshon nga një vend në tjetrin?
- Si mundet një biznes shqiptar të jetë modern pa e harruar traditën shqiptare?

3 Zgjidh sipas kulturës

Një biznes shet ushqime në vende të ndryshme.

Rretho zgjedhjen që mendon se përshtatet më mirë:

- Ushqim tradicional / Ushqim ndërkombëtar
- Ushqim me mish / Ushqim pa mish
- Ushqim djegës / Ushqim jo djegës

Trego:

Pse zgjodhe këtë?

Si ndikon kultura në këtë zgjedhje?

Në cilin vend mendon se përshtatet më shumë zgjedhja jote?

4 Ti je sipërmarrës

Do të hapësh një biznes në një vend tjetër:

- Çfarë do të shesësh?
- Kujt do t'ia shesësh?
- Çfarë do të ndryshosh në produkt ose shërbim?
- Pse mendon se klientët do ta pëlqejnë?



5 Dilemë kulturore

Një biznes duhet të zgjedhë të shesë produktin si në vendin e tij ose ta ndryshojë sipas kulturës së vendit tjetër.

Si do të veproje ti?

Argumento përgjigjen.

Diskuto:

- Pse është e rëndësishme kultura për biznesin?
- Çfarë ndodh nëse biznesi nuk e kupton klientin?
- A duhet që bizneset të përshtaten në çdo vend?
- A ndikon kultura kur blejmë në tregun online (P.sh. madhësitë e rrobave që ndryshojnë nga Azia në Europë).

Mbaj mend!

- Kultura ndikon në zgjedhjet e klientëve.
- Njerëzit në vende të ndryshme kanë zakone të ndryshme.
- Bizneset duhet të përshtaten me kulturën.
- Njohja e kulturës ndihmon biznesin të ketë sukses.

Reflekto

- Çfarë mësove për lidhjen midis biznesit dhe kulturës?
- Si ndikojnë zakonet në zgjedhjet e tua si klient?
- Pse është e rëndësishme që bizneset të kuptojnë kulturën?

Aktivitetet e këtij mësimi mund të zhvillohen edhe duke përdorur platformën digjitale: lms.junior-albania.org/course.



Rezultatet e të nxënit:

- identifikon arsyet e tregtisë ndërmjet vendeve;
- krahason përfitimet e tregtisë me plotësimin e nevojave në mënyrë të pavarur;
- përdor termat kyçe që lidhen me tregtinë;
- vlerëson ndikimin e përmirësimeve teknologjike në zhvillimin e tregtisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Tregti, tregti ndërkombëtare, shkëmbim, import, eksport, burime, teknologji.

Për ditëlindje të dhuruan titullin e ri të serisë “Ditarët e Peshkopes”. Ky është libri i preferuar i shoqes sate të ngushtë. Shoqja jote ka albumin e fundit të këngëtares Olivia Rodrigues. Ti i sugjeron shoqes t’i shkëmbeni me njëra-tjetrën librin me albumin.

- Pse e bërë shkëmbimin? ➤ Çfarë fitove? ➤ Çfarë morët nga njëri-tjetri?



- A ndodh kjo vetëm mes njerëzve apo edhe mes vendeve?

Tregtia

Tregtia është shkëmbimi i produkteve ose shërbimeve me qëllim përfitimi ose plotësimi nevojash. Njerëzit tregtojnë sepse:

- duan diçka që nuk e kanë; ➤ kanë diçka që mund ta shkëmbejnë.

Tregtia mund të zhvillohet brenda një vendi (tregti e brendshme) ose midis vendeve të ndryshme (tregti ndërkombëtare). Tregtia e brendshme është shkëmbimi i produkteve dhe shërbimeve brenda një vendi.



- Pse njerëzit bëjnë shkëmbime?

Tregtia ndërkombëtare

Tregtia ndërkombëtare është shkëmbimi i produkteve dhe shërbimeve ndërmjet vendeve të ndryshme. Vende të ndryshme përdorin monedha të ndryshme në tregti. Tregtia ndërkombëtare lidh vendet me njëra - tjetrën (krijon tregtinë globale). Kjo ndodh sepse vendet kanë burime të ndryshme dhe nuk prodhojnë gjithçka.



- Pse vendet nuk prodhojnë gjithçka vetë?
- A përfitojnë të gjitha vendet njësoj nga tregtia?

Burimet dhe nevojat

Çdo vend ka disa burime, por nuk i ka të gjitha burimet që i duhen për të plotësuar nevojat. Për këtë arsye, vendet përdorin burimet që kanë dhe tregtojnë me njëra-tjetrën ato që u mungojnë.



- Çfarë do të ndodhte nëse një vend nuk do të tregtonte?

Importi dhe eksporti

Importi është një produkt ose shërbim, që blihet nga një vend tjetër, pra hyrja e produktit në vend. Eksporti është një produkt apo shërbim, që shitet në një vend tjetër, pra dalja e produktit nga vendi.



- Jep një shembull të një produkti ose shërbimi të importuar dhe të një produkti ose shërbimi të eksportuar.

Teknologjia dhe tregtia

Teknologjia ka ndryshuar tregtinë duke e bërë më të shpejtë, më të lehtë dhe të shtrirë në shumë vende p.sh. transporti, komunikimi dhe interneti.



- Si ndikon interneti në tregtinë sot?
- Si ndikon transporti i produkteve nga një anë e botës në tjetrën të mjedisi?



Rëndësia e tregtisë

Vendet nuk mund të plotësojnë të gjitha nevojat vetë. Ato përfitojnë më shumë kur tregtojnë.

Rast studimor - Një vend dhe tregtia

Një vend prodhon shumë kafe, por nuk prodhon makina. Kështu ai eksporton kafe dhe importon makina.



- Pse ky vend eksporton kafe?
- Pse importon makina?
- A mund t'i prodhojë vetë të gjitha?
- Çfarë përfiton nga tregtia?

1 Punë në grup. “Shkëmbimi”

Sill produkte të ndryshme në klasë. Shkëmbe produkte me shokun ose shoqen për të marrë një ushqim, një veshje ose një produkt tjetër. Diskuto:

- Pse bërë shkëmbimin?
- A u ndjeve më i kënaqur pas shkëmbimit?

2 Import dhe eksport

Plotëso tabelën.

Vendi	Eksporton	Importon
Shqipëria	Fruta, perime	Makina, teknologji
Japonia	Makina, pajisje elektronike	Naftë, lëndë të para

- Pse vendet importojnë dhe eksportojnë produkte?

3 Partnerët tregtarë

Shiko hartën e tregtisë dhe plotëso fjalitë.

- Emri i vendit _____
- Çfarë eksporton _____

- Partneri i tij tregtar _____
- Çfarë importon _____



4 Teknologjia dhe tregtia

Shkruaj:

- Një mënyrë si teknologjia ndihmon tregtinë _____

Diskuto:

- Si do të ishte tregtia pa teknologji?

5 Dilema tregtare

Një vend duhet të zgjedhë të prodhojë gjithçka vetë apo të bëjë tregti me vende të tjera.

Si do të veproje ti? Pse?

Diskuto

- Pse vendet tregtojnë?
- Çfarë ndodh nëse nuk ka tregti?
- Si ndikon teknologjia në tregti?
- A është e mundur një botë pa tregti?

Mbaj mend!

- Tregtia është shkëmbimi i produkteve dhe shërbimeve.
- Tregtia ndërkombëtare ndodh midis vendeve të ndryshme.
- Vendet importojnë dhe eksportojnë.
- Vendet tregtojnë sepse nuk kanë të gjitha burimet që u nevojiten.
- Teknologjia e bën tregtinë më të lehtë.
- Tregtia është e domosdoshme.

Reflekto

- Pse është e rëndësishme tregtia për vendet?
- Çfarë mësove për importin dhe eksportin?
- Si ndikon teknologjia në tregtinë sot?

Aktivitetet e këtij mësimi mund të zhvillohen edhe duke përdorur platformën digjitale: lms.junior-albania.org/course.

3.4 Specializimi i vendeve në prodhim dhe tregti



Rezultatet e të nxënit:

- përkufizon konceptin e specializimit;
- tregon përmes shembujve se vendet nuk mund të prodhojnë gjithçka që u nevojitet;
- identifikon marrëdhëniet shkaktë-pasojë ndërmjet ngjarjeve dhe vendimeve në një vend dhe ndikimit të tyre te klientët në një vend tjetër;
- identifikon ndikimin e specializimit në uljen e kostove dhe rritjen e efikasitetit.

*Specializim, prodhim,
kosto, efikasitet,
ndërvarësi, tregti.*

Mësuesja ju ka ndarë në grupe dhe keni detyrë të realizoni bërjen e një produkti. Secili pjesëtar i grupit ka detyrë të veçantë.

➤ **Nxënësi 1** vizaton produktin.

➤ **Nxënësi 2** shkruan emrin dhe përshkrimin e produktit.

➤ **Nxënësi 3** mendon çmimin dhe përdorimin e tij.



➤ A ishte më e lehtë puna kur secili nxënës kishte një detyrë?

➤ A do të ishte më e vështirë nëse një person do të bënte gjithçka?

Specializimi

Specializimi është procesi kur njerëzit, bizneset ose vendet përqendrohen në prodhimin e një ose disa produkteve që i bëjnë më mirë.

Kjo u mundëson:

➤ të bëhen më të aftë;

➤ të prodhojnë më shpejt;

➤ të prodhojnë me kosto më të ulët.

Kur ka specializim:

➤ puna ndahet;

➤ prodhimi rritet;

➤ kostot ulen.



➤ Si ndikon ndarja e punës në koston dhe çmimin e një produkti?

Pse vendet specializohen?

Vendet nuk mund të prodhojnë gjithçka sepse kanë burime të ndryshme dhe kushte të ndryshme prodhimi. Për këtë arsye ato specializohen në një lloj produkti dhe tregtojnë me njëra-tjetrën. Specializimi i bën vendet të varen më shumë nga njëri-tjetri.



➤ A është gjithmonë specializimi i dobishëm për një vend?

Ndërvarësia

Ndërvarësi quhet kur njerëzit, bizneset, vendet varen nga njëra-tjetra për produkte dhe shërbime.

P.sh. një vend prodhon pjesë ndërsa një vend tjetër i monton dhe i shet. Ndërvarësia globale do të thotë që vendet e botës janë të lidhura me njëra-tjetrën përmes prodhimit, tregtisë dhe përdorimit të burimeve.

Disa vende kanë:

➤ më shumë lëndë të para;

➤ klimë më të përshtatshme;

➤ teknologji më të zhvilluar;

➤ fuqi punëtore të specializuar.

Shembull. Kompania Apple prodhon iPhone. Ajo e bën dizajnin në SHBA, pjesët e prodhon në Kore dhe Japoni, ndërsa montimi bëhet në Kinë.



➤ Çfarë ndodh nëse një vend ndalon prodhimin?

Shkak dhe pasojë në tregti

Vendimet në një vend ndikojnë në vende të tjera. Për shembull rritja e çmimit të një produkti ndikon te klientët në vende të tjera. Kur çmimi i naftës rritet në Lindjen e Mesme, çmimet e transportit rriten edhe në Shqipëri.

Përfitimet e specializimit

Kur ka specializim:

- prodhohet më shumë në më pak kohë;
- punohet më me efikasitet (puna bëhet më shpejt dhe më mirë, duke përdorur më pak kohë dhe burime);
- rritet cilësia e produktit;
- ulen kostot e prodhimit (më pak para duke përdorur më pak kohë).

Kjo do të thotë se specializimi i sjell përfitime si prodhuesit, ashtu edhe klientit.



- Cili mendon se është përfitimi më i madh i specializimit?

Rast studimor

Prodhimi ndërkombëtar i makinave

Një kompani prodhon pjesë në një vend. Ajo i monton në një vend tjetër dhe i shet në tregje të ndryshme.



- Pse prodhimi ndahet në vende të ndryshme?
- Çfarë ndodh nëse një vend ndalon prodhimin?
- Si ndikon kjo te klientët në vende të tjera?



1 Krijë një model të thjeshtë “bluze” në letër.

Ndaj rolet

- Nxënësi 1 vizaton formën e bluzës.
- Nxënësi 2 e pret modelin.
- Nxënësi 3 shkruan një logo ose emër për bluzën.
- Nxënësi 4 përgatit prezantimin.

Diskuto në grup

- A përfunduat më shpejt, kur secili kishte një detyrë?
- Çfarë ndodhi kur secili u përqendrua vetëm në një pjesë të punës?
- A do të ishte më e vështirë nëse një person do të bënte gjithçka?

2 Specializimi në praktikë

Plotëso tabelën për një detyrë tjetër sipas shembullit të bluzës:

Detyra	Kush e kryen

- Si ndihmon ndarja e punës në prodhim?

3 Pse vendet tregtojnë?

Plotëso fjalinë (për një vend konkret):

- Një vend ka _____
- Ai nuk ka _____
- Vendi e merr _____

4 Ndërvarësia globale

- Një produkt që vjen nga disa vende _____

Diskuto:

- Sa vende mund të marrin pjesë në prodhimin e tij?

5 Shkak-pasojë

Plotëso fjalinë.

Nëse një vend ndalon prodhimin e _____ atëherë në një vend tjetër _____.

Diskuto

- Pse është i rëndësishëm specializimi?
- Pse vendet nuk janë të pavarura plotësisht?
- Si lidhen vendet me njëra-tjetrën?

Mbaj mend!

- Specializim do të thotë të përqendrohesh në disa produkte.
- Specializimi rrit efikasitetin dhe ul kostot.
- Vendet nuk mund të plotësojnë të gjitha nevojat vetë.
- Vendet varen nga njëra-tjetra (ndërvarësi).
- Vendimet në një vend ndikojnë në vende të tjera.

Reflekto

- Pse vendet specializohen?
- Si ndikon specializimi në jetën tënde?
- Si ndikojnë vendimet e një vendi te të tjerët?



Aktivitetet e këtij mësimi mund të zhvillohen edhe duke përdorur platformën digjitale: lms.junior-albania.org/course.

3.5 Barrierat tregtare



Rezultatet e të nxënit:

- identifikon shembuj të barrierave tregtare;
- analizon pasojat e barrierave tregtare për bizneset, punonjësit dhe klientët;
- dallon si ndikojnë barrierat tregtare në marrëdhëniet tregtare ndërmjet vendeve.

*Barrierë tregtare,
tarifë, kuotë, subvencion,
standard, tregti.*

Ti dëshiron të blesh një produkt nga një vend tjetër (p.sh. online), por ai është shumë më i shtrenjtë se zakonisht.



- Pse mund të jetë bërë më i shtrenjtë?
- A mund të ketë rregulla që e bëjnë më të vështirë blerjen e tij?

Barriera tregtare

Një barrierë tregtare është një rregull ose ligj që e bën më të vështirë, e ngadalëson ose e ndalon tregtinë midis vendeve.

Barrierat mund të kufizojnë tregtinë dhe të mbrojnë prodhuesit vendas. Ato ndikojnë në çmimet, zgjedhjet dhe konkurrencën në treg.



- Pse një vend do të vendoste rregulla/barriera për tregtinë?

Barrierat tregtare janë si më poshtë:

A. Tarifat

Tarifa është një taksë që vendoset mbi produktet e importuara.

Kjo do të thotë që produkti bëhet më i shtrenjtë dhe njerëzit mund të blejnë më shumë produkte vendase.



- Si ndikon rritja e çmimit te zgjedhja e klientit?

B. Kuotat

Kuota është një kufi për sasinë e produkteve që mund të importohen në një vend.

Kjo do të thotë që në një vend nuk mund të hyjë një sasi e madhe produktesh dhe produktet bëhen më të pakta. Shqipëria ka kuota për importin e disa produkteve bujqësore për të mbrojtur fermerët vendas. P.sh. kuota për mollët e importuara gjatë sezonit të vjeljes së mollëve shqiptare.



- Çfarë ndodh kur një produkt është i kufizuar?

C. Subvencionet

Subvencioni është ndihmë financiare që jepet nga qeveria për bizneset vendase.

P.sh. nëse shteti ndihmon fermerin shqiptar me naftë falas, ai mund ta shesë mollën më lirë se molla që vjen nga jashtë. Kjo ndihmon në uljen e kostos së prodhimit dhe uljen e çmimit të produktit.



- Si ndikon subvencioni te konkurrenca me produkte të huaja?



D. Standardet

Standardet janë rregulla që përcaktojnë cilësinë dhe mënyrën e prodhimit të një produkti. Për shembull standardet mbi sigurinë ushqimore dhe standardet mbi mënyrën e paketimit. Standardet mund të jenë edhe barrierë. P.sh. nëse një shtet kërkon një paketim shumë të shtrenjtë që një biznes i vogël i huaj nuk e bën dot, atëherë ky standard kthehet në barrierë.



➤ Pse janë të rëndësishme standardet për konsumatorët?

Ndikimi i barrierave tregtare

Barrierat tregtare mund të kenë pasoja të ndryshme. Ato mbrojnë bizneset vendase dhe krijojnë vende pune. Nga ana tjetër ato rrisin çmimet dhe kufizojnë zgjedhjet për klientët.



➤ A janë gjithmonë të dobishme barrierat tregtare?

Rast studimor - Tarifa mbi këpucët.

Një kompani prodhon këpucë jashtë vendit dhe i shet në një vend tjetër. Qeveria vendos një tarifë mbi këto këpucë. Për pasojë çmimi rritet dhe klientët paguajnë më shumë. Nga ana tjetër bizneset vendase mund të shesin më shumë.



- Kush përfiton nga tarifa?
- Kush humbet?
- A është e drejtë kjo situatë për të gjithë?

1 Llojet e barrierave

Plotëso tabelën.

Barriera	Çfarë bën
Tarifë	
Kuotë	
Subvencion	
Standard	

2 Kush ndikohet?

Plotëso tabelën.

Grupi	Si ndikohet
Klientët	
Bizneset	
Punonjësit	

3 Zgjidh dhe argumento

Zgjidh një alternativë:

- › çmime më të ulëta për produkte të importuara OSE
- › mbrojtje për bizneset vendase

Argumento zgjedhjen tënde.

4 Jep shembuj

- › një produkt që mund të ketë tarifë _____
- › një produkt që mund të ketë standard _____
- › një produkt që blihet online mund të ketë tarifë _____

5 Argumento

- › Barrierat tregtare ndihmojnë _____
- › Barrierat tregtare dëmtojnë _____

Plotëso tabelën.

Barrierat tregtare	Përfitimet (Pro)	Pasojat negative (Kundër)
Tarifa		
Kuota		
Subvencioni		
Standardet		

- › Pse vendet vendosin barrierat tregtare?
- › A duhet të ketë gjithmonë tregti të lirë (pa barrierat)?
- › Si ndikojnë barrierat te klientët?



Mbaj mend!

- › Barrierat tregtare janë rregulla që kufizojnë tregtinë.
- › Tarifat rrisin çmimet.
- › Kuotat kufizojnë sasinë.
- › Subvencionet ndihmojnë bizneset vendase.
- › Standardet sigurojnë cilësinë.
- › Barrierat mund të ndihmojnë ose të dëmtojnë.



Reflekto

- › Cila barrierë tregtare të duket më e rëndësishme?
- › Si ndikojnë barrierat në jetën tënde si konsumator?
- › A janë gjithmonë të drejta këto rregulla?



Aktivitetet e këtij mësimi mund të zhvillohen edhe duke përdorur platformën digjitale: lms.junior-albania.org/course.

3.6 Monedha dhe kursi i këmbimit



Rezultatet e të nxënës:

- përkufizon monedhën dhe kursin e këmbimit;
- dallon përdorimin e monedhave të ndryshme në vende të ndryshme;
- dallon ndryshimin e vlerës së parasë sipas kursit të këmbimit.

Monedhë, para, kurs këmbimi, vlerë, konvertim, çmim, fuqi blerëse.

Ti ke 100 lekë dhe dëshiron të blesh diçka.



- > Çfarë mund të blesh me këtë shumë?
- > A mund të përdorësh të njëjtën monedhë (para) në çdo vend?

Monedha

Monedha është paraja specifike e një vendi. Në botë ka shumë monedha të ndryshme.



- > Cilat monedha njeh?

Monedha të ndryshme

Vende të ndryshme përdorin monedha të ndryshme. Për shembull në vendin tonë monedha është leku (simboli ndërkombëtar është ALL), një pjesë e vendeve të Europës përdor euron (EUR), Shtetet e Bashkuara të Amerikës përdorin si monedhë dollarin amerikan (USD) etj. Kur udhëtojmë, duhet të shkëmbejmë monedhën.

Kursi i këmbimit

Kursi i këmbimit është çmimi i një monedhe të një shteti në krahasim me një monedhë të një shteti tjetër. Ai nuk është i njëjtë gjithmonë dhe mund të ndryshojë çdo ditë.



- > Pse mendon se ndryshon kursi i këmbimit?

Konvertimi i monedhës

Konvertimi është ndryshimi i një monedhe në një tjetër. Për shembull: 1 euro = 96 lekë. Konvertimi i monedhës është i nevojshëm edhe kur udhëtojmë në një vend tjetër, kur bëjmë blerje online nga vende të tjera etj. Për të bërë konvertime përdoren makina llogaritëse online ose aplikacione. Përpara se të përdorësh kursin e këmbimit, kontrollo kursin zyrtar të ditës në faqen e Bankës së Shqipërisë ose në Google. Kur këmbëjmë para në pikë këmbimi (Exchange), ata mbajnë një komision të vogël ose kanë kurs shitje/ blerje.

Fuqia blerëse

Fuqia blerëse tregon sa produkte mund të blesh me një shumë parash. Me të njëjtën shumë parash mund të blejmë më shumë në një vend dhe më pak në një tjetër. Për shembull: Nëse me 100 lekë blen 2 akullore në lagjen tënde, por në një vend turistik blen vetëm 1 akullore, ky quhet ndryshim i fuqisë blerëse.



- > Ku mendon se mund të blesh më shumë me të njëjtën shumë?

Çmimet ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Ndryshimi i kursit të këmbimit ndikon në çmimet që paguajmë për produkte në vende të ndryshme. Për të krahasuar çmimet duhet t'i kthejmë në të njëjtën monedhë.

Rast studimor - Krahasimi i çmimeve.

Një aparat fotografik shitet:

- > në SHBA: 160 dollarë (\$)
- > në Europë: 140 euro (€)
- > në Shqipëri: 12 500 lekë (ALL)
- > në Angli: 130 paund (£)



- > Në cilin vend do ta blije produktin dhe pse?
- > Si ndikon kursi i këmbimit në vendimin për të blerë?

1 Monedhat

Plotëso fjalitë.

- > Monedhë quhet _____
- > Monedha e Shqipërisë _____
- > Një monedhë tjetër që njeh _____



2 Kursi i këmbimit

Plotëso fjalitë.

- > Kursi i këmbimit është _____
- > 1 dollar = _____ (lekë)
- > 1 euro = _____ (lekë)

Diskuto:

- > A ndryshon kjo vlerë?

3 Konverto monedhën në lekë

Plotëso tabelën.

Monedha	Vlera
1 dollar	
10 dollarë	
1 euro	
10 euro	

4 Krahaso çmimet

Plotëso tabelën duke llogaritur koston në euro dhe në dollarë. Shto edhe dy produkte të tjera që mund t'i blësh online nga jashtë.

Produkti	Kosto në lekë (ALL)	Kosto në EURO	Kosto në USD
Celular	40,000		
Orë dore	10,000		
Aparat fotografik	20,000		
Syze dielli	2,000		
Këpucë sportive	8,500		
Kuti me çokollata	3,000		

5 Mendim kritik

Analizo:

- Kursi i këmbimit ndikon në _____
- Çmimet ndryshojnë sepse _____

Diskuto:

- Pse vendet kanë monedha të ndryshme?
- Pse ndryshojnë çmimet nga një vend në tjetrin?
- Si ndikon kursi i këmbimit në blerjet tona?
- A është gjithmonë më mirë të blehesh më lirë nga një vend tjetër?



Mbaj mend!

- Monedha është paraja e një vendi.
- Ka shumë monedha në botë.
- Kursi i këmbimit tregon vlerën e monedhave.
- Kursi ndryshon me kalimin e kohës.
- E njëjta shumë parash nuk ka të njëjtën vlerë në çdo vend.



Reflekto

- Çfarë është kursi i këmbimit?
- Pse nuk kanë të gjitha monedhat të njëjtën vlerë?
- Si ndikon kjo në blerjet tona?



Aktivitetet e këtij mësimi mund të zhvillohen edhe duke përdorur platformën digjitale: lms.junior-albania.org/course.



3.7

Fuqia punëtore globale



Rezultatet e të nxënit:

- përshkruan si bizneset përdorin teknologjinë dhe komunikimin për të gjetur punonjës në vende të ndryshme;
- analizon hapat për të gjetur punë në një vend tjetër;
- vlerëson rëndësinë e njohjes së një gjuhe të huaj për punësim në tregun global.

*Fuqi punëtore globale,
punësim, aftësi, teknologji,
komunikim, gjuhë e huaj,
përvojë.*

Kur një kompani kërkon punonjës, ajo mund të zgjedhë njerëz nga vende të ndryshme.



- Pse një kompani nuk zgjedh vetëm punonjës nga vendi i saj?
- Çfarë aftësish duhet të ketë një person për të punuar jashtë vendit?

Fuqia punëtore globale

Fuqia punëtore globale përfshin njerëz nga vende të ndryshme, që punojnë për biznese në mbarë botën. Konkurrenca do të thotë se ka shumë të tjerë me aftësi të ngjashme, prandaj përgatitja profesionale bëhet e rëndësishme. Sot bizneset mund të punësojnë njerëz nga vende të ndryshme. Ato përdorin teknologjinë për komunikim. Tregu global i punës krijon më shumë mundësi, por edhe më shumë konkurrencë për fuqi punëtore.



> Si ndihmon interneti në punësimin ndërkombëtar?



Roli i teknologjisë

Teknologjia ndihmon bizneset të komunikojnë me punonjës në vende të tjera dhe të zgjedhin punonjësit më të kualifikuar. Shumë njerëz sot punojnë online për kompani të huaja pa u larguar nga vendi i tyre falë teknologjisë.

Aftësitë për të punuar jashtë

Për të punuar në një vend tjetër, një person duhet të ketë:

- > njohuri për vendin, kulturën, zakonet dhe mënyrën e jetesës;
- > aftësi teknologjike, përdorimi i kompjuterit, komunikim online, etj.;
- > aftësi komunikimi me njerëz nga kultura të ndryshme, bashkëpunim në grup, menaxhimi i kohës etj.

Gjuha e huaj

Njohja e një gjuhe të dytë ndihmon komunikimin dhe hap më shumë mundësi pune. P.sh. një nxënës shqiptar që di anglisht mund të aplikojë për punë në kompani të BE-së, të punojë online ose të komunikojë me partnerë ndërkombëtarë.



> Pse është e rëndësishme të dish një gjuhë të huaj?

Punësimi në vende të tjera

Për të punuar jashtë vendit, një person duhet të ketë:

- > dokumente (pasaportë, leje pune);
- > njohuri për ligjet dhe rregullat;
- > përgatitje dhe gatishmëri për jetesën në një kulturë tjetër.

Rast studimor - Çfarë nuk shkoi mirë?

Një person dëshiron të punojë jashtë vendit, por nuk di gjuhën, nuk njeh kulturën dhe nuk ka aftësi pune ndërkombëtare.



- > Çfarë hapash duhet të ndërmarre ai për të arritur qëllimin e tij?
- > Cilat njohuri dhe aftësi i mungojnë?

Rast suksesi

Albana punon si dizajnere grafike online për një kompani suedeze. Dinte anglisht, kishte aftësi të mira komunikuese dhe kishte bërë trajnim digjital online.



➤ Si e ndihmuan gjuhët e huaja dhe aftësitë digjitale Albanën në tregun global të punës?

- 1 Aftësitë për punë**
Shkruaj 3 aftësi që duhet të ketë një person për të punuar jashtë:
➤ _____ ➤ _____ ➤ _____

- 2 Gjuha dhe puna**
Plotëso fjalitë.
➤ Një gjuhë e huaj ndihmon _____
➤ Mundësitë e punës rriten kur _____

- 3 Çfarë duhet për të punuar jashtë?**
Plotëso fjalitë.
➤ Dokumentet që duhen _____

- 5 Mendim kritik**
Plotëso fjalitë.
➤ Një biznes zgjedh punonjës nga vende të tjera sepse _____.
➤ Një punonjës duhet të përgatitet duke _____.
Diskuto
➤ A është gjithmonë e drejtë që kompanitë të zgjedhin punonjës nga vende të tjera?
➤ Si ndikon teknologjia në punësim?
➤ Cilat janë aftësitë më të rëndësishme që duhet të zhvillosh?

- 4 Punë në grup**
Zgjidhni kandidatin më të përshtatshëm për një punë ndërkombëtare.

Për secilin kandidat mendoni:
➤ çfarë di të bëjë;
➤ cilat janë aftësitë e tij;
➤ a di gjuhë të huaja;
➤ a ka përvojë, njohuri për vende të tjera.

Krahasoni kandidatët.
➤ Cili kandidat ka më shumë aftësi pune ndërkombëtare?
➤ Cili komunikon më mirë?
➤ Cili përshtatet më lehtë me kulturë tjetër?

Zgjidhni kandidatin më të përshtatshëm.
Plotësoni:
➤ Kandidati ynë është _____

Argumento zgjedhjen.
➤ E zgjodhëm sepse _____.
➤ Aftësitë kryesore janë _____.
➤ Ai/Ajo është i përshtatshëm për punë ndërkombëtare sepse _____.
Përfaqësuesi i grupit prezanton zgjedhjen.

Mbaj mend!

- Bizneset mund të punësojnë punonjës nga e gjithë bota.
- Teknologjia ndihmon komunikimin dhe punësimin.
- Njohja e gjuhëve të huaja është shumë e rëndësishme.
- Punësimi ndërkombëtar kërkon aftësi dhe përgatitje.

Reflekto

- Çfarë aftësish duhet të zhvillosh për të punuar në të ardhmen?
- Pse është e rëndësishme të njohësh kultura të ndryshme?
- Si mund të përgatitesh për tregun global të punës?



Aktivitetet e këtij mësimi mund të zhvillohen edhe duke përdorur platformën digjitale:
lms.junior-albania.org/course.

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT

Tregu global



KONCEPTET KRYESORE TË KAPITULLIT

1. Biznesi dhe klienti

- › Biznesi ofron produkte ose shërbime.
- › Klienti blen produkte ose shërbime.
- › Biznesi dhe klienti lidhen me njëri-tjetrin në treg.

2. Kultura dhe biznesi

- › Kultura ndikon në zgjedhjet e klientëve.
- › Bizneset duhet të kuptojnë zakonet, traditat dhe preferencat e klientëve.

3. Tregtia globale

- › Vendet tregtojnë sepse nuk kanë të gjitha burimet dhe produktet që u duhen.
- › Tregtia ndërkombëtare përfshin importin dhe eksportin.

4. Specializimi

- › Vendet dhe bizneset specializohen në atë që prodhojnë më mirë.
- › Specializimi rrit efikasitetin, ul kostot dhe lidhet me ndërvarësinë.

5. Barrierat tregtare

- › Barrierat tregtare mund të kufizojnë ose të ngadalësojnë tregtinë.
- › Tarifat, kuotat, subvencionet dhe standardet ndikojnë te bizneset dhe klientët.

6. Monedha dhe kursi i këmbimit

- › Çdo vend ka monedhën e tij.
- › Kursi i këmbimit tregon vlerën e një monedhe në krahasim me një tjetër.
- › Kursi ndikon në çmimet që paguajmë.

7. Fuqia punëtore globale

- › Bizneset mund të punësojnë njerëz nga vende të ndryshme.
- › Teknologjia, gjuhët e huaja dhe aftësitë e komunikimit janë shumë të rëndësishme.

Një kompani shqiptare prodhon një produkt. Ajo e reklamoi produktin online, e shet në vende të tjera dhe merr pagesa në monedha të ndryshme. Kompania ka punësuar njerëz nga disa vende.



- › Cilat koncepte të kapitullit shikon në këtë situatë?
- › Pse kjo kompani nuk mund të punojë e shkëputur nga vendet e tjera?

1 Lidh konceptet me shpjegimin e duhur.

Koncepti

Biznesi
Klienti
Tregtia ndërkombëtare
Monedha
Specializimi

Shpjegimi

- paraja e një vendi
- shkëmbimi i produkteve dhe shërbimeve ndërmjet vendeve
- personi që blen
- veprimtari që shet produkte ose shërbime
- përqendrimi në prodhimin e disa produkteve

2 Plotëso skemën e kapitullit

Biznesi → Klienti → Tregu → Tregtia ndërkombëtare → Specializimi → Barrierat tregtare → Monedha → Fuqia punëtore globale

Detyrë: Shpjego me 1 fjali lidhjen mes çdo dy koncepteve.

3 E vërtetë apo e gabuar?

Shkruaj V për të vërtetë dhe G për të gabuar.

- Të gjitha vendet prodhojnë gjithçka që u duhet.
- Kultura ndikon në zgjedhjet e klientëve.
- Tarifa është një taksë mbi importet.
- Kursi i këmbimit nuk ndryshon kurrë.
- Njohja e një gjuhe të huaj mund të ndihmojë për punësim ndërkombëtar.

PROJEKT: Kompania jonë në tregun global

Punoni në grupe me 4–5 nxënës.

Imagjinoni sikur keni një kompani të vogël shqiptare që dëshiron të shesë një produkt në tregun ndërkombëtar. Produkti juaj mund të jetë nga kultura, ushqimi, arti, teknologjia ose çdo fushë tjetër. Zgjidhni:

- emrin e kompanisë;
- produktin ose shërbimin;
- vendin ku doni ta shisni.

Detyrat e grupit

1. Biznesi dhe klienti

- Çfarë shet kompania juaj?
- Kush janë klientët tuaj?

2. Kultura

- Çfarë duhet të dini për kulturën e klientëve?
- A duhet ta përshtatni produktin? Si?

3. Tregtia globale

- A do ta eksportoni produktin?
- Çfarë burimesh keni dhe ju duhen?

4. Specializimi

- Per çfarë është e specializuar kompania juaj?
- Pse e bën më të fortë kjo gjë?

5. Barrierat tregtare

- A mund të hasni tarifa, kuota ose standarde?
- Si do t'i përballoni?

6. Monedha

- Në çfarë monedhe do të shisni?
- Si ndikon kursi i këmbimit?

7. Fuqia punëtore globale

- A do t'ju duhen punonjës me gjuhë të huaj ose aftësi teknologjike?

Produkti përfundimtar i projektit

Grupi përgatit një poster, fletë prezantimi ose skemë me këto rubrika:

Rubrika	Përgjigjja e grupit
Emri i kompanisë	
Produkti/Shërbimi	
Klientët	
Vendi ku do të shitet	
Përshtatja kulturore	
Monedha	
Vështirësitë e mundshme	
Pse mund të ketë sukses	

Prezantimi

Çdo grup prezanton për 2–3 minuta:

- çfarë ka krijuar;
- pse e ka zgjedhur atë ide;
- cilat koncepte të kapitullit ka përdorur.



Pjesa A – Zgjidh alternativën e saktë

1. Klienti është:

- A) ai që blen;
- B) ai që shet;
- C) ai që prodhon;
- D) ai që reklamon.

2. Tregtia ndërkombëtare është:

- A) shkëmbimi brenda një qyteti;
- B) shkëmbimi vetëm i parave;
- C) shkëmbimi midis vendeve;
- D) shkëmbimi vetëm i mallrave.

3. Specializim do të thotë:

- A) të prodhosh gjithçka;
- B) të përqendrohesh në disa produkte ose detyra;
- C) të mos tregtosh fare;
- D) të mos shesësh fare.

4. Tarifa është:

- A) ndihmë për bizneset vendase;
- B) taksë mbi importet;
- C) kufi për sasinë e importeve;
- D) kursi i këmbimit.

5. Kursi i këmbimit tregon:

- A) cilësinë e produktit;
- B) taksën mbi importet;
- C) sa punonjës ka një biznes;
- D) vlerën e një monedhe në krahasim me një tjetër.

Pjesa B – Plotëso.

6. Monedha e Shqipërisë është _____.

7. Një produkt që vjen nga një vend tjetër quhet _____.

8. Një person që blen një produkt quhet _____.

9. Njohja e një gjuhe të huaj ndihmon në _____.

10. Kur vendet varen nga njëra-tjetra për produkte dhe shërbime kemi _____.

Pjesa C – Mendo dhe argumento.

11. Pse bizneset duhet të kuptojnë kulturën e klientëve?

12. Pse vendet nuk mund të prodhojnë gjithçka vetë?

13. Si ndikon kursi i këmbimit në blerjet tona?

14. A janë barrierat tregtare gjithmonë të dobishme? Pse?



Reflekt:

- Cili mësim të ka ndihmuar më shumë të kuptosh ekonominë globale?
- Cili koncept të duket më i rëndësishëm për jetën e përditshme?
- Si lidhen të gjitha mësimet e kapitullit me njëri-tjetrin?



Projekti dhe quiz-i mund të zhvillohen edhe duke përdorur platformën digjitale:
ims.junior-albania.org/course.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Bardhi, Ylli

Qytetari 6 / Ylli Bardhi, Estela Mano ; red. Lisina Mano. -
Tiranë : SHBLSH e Re, 2026.

... f. ; ... cm.

ISBN 97899943-2-517-7

I.Mano, Estela

1.Qytetaria 2.Edukimi 3.Tekste për shkollat 9-vjeçare

37 .017.4 (075.2)